



RAPORTI I DËGJESAVE PUBLIKE PËR HARTIMIN E BUXHETIT 2026 DHE PBA 2026-2028

(Bazuar në materialet prezantuese të hartuar nga cdo drejtor i menaxhimit të programit gjatë organizimit të dëgjesave publike, diskutimeve dhe sugjerimevetë pjesmarrësve etj.)

Përgatitur nga:
Sektorit të Analizës Statistikës dhe Planifikimit Afatmesëm
Drejtoria e Buxhetit
Bashkia Durrës

Nëntor 2025

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1 – HYRJE FAQE 3-6

KAPITULLI 2 – REKOMANDIMET E DALA NGA DËGJESAT FAQE 7–9

KAPITULLI 3 – PROCESVERBALET FAQE 10–25

KAPITULLI 4 – MATERIALET E PREZANTUARA FAQE 26–75

KAPITULLI 5 – FOTO NGA DËGJESAT PUBLIKE FAQE 76–81

KAPITULLI 1

1. HYRJE

Në kuadër të përgatitjes dhe hartimit të Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, si dhe të transparencës publike për projektet, shërbimet dhe investimet e realizuara gjatë vitit 2025, Bashkia Durrës bashkë me Këshillin Bashkiak Durrës organizoi **Dëgjesa Publike** për programet kryesore të zhvillimit.

Këto dëgjesa shërbyen për informimin, edukimin dhe përfshirjen e publikut në procesin buxhetor, në përputhje me Ligjin nr. 146/2014 “Për konsultimin publik”.

Bazuar në Ligjin 146/2014 “Për konsultimin publik”, Bashkia ka krijuar të gjitha mundësitë për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e hartimit të buxhetit vjetor dhe sidomos të prioriteteve buxhetore, si dhe për të mirëpritur çdo propozim nga ana e pjesëmarrësve.

Raporti përmbledhës hartohet në zbatim të:

- Ligjit nr. 146/2014 “Për konsultimin publik”;
- Ligjit nr. 86/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ky raport do t’i bashkëlidhet **draftit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028**.

Raporti më analitik i dëgjesave publike nga cdo drejtori dhe për cdo program përmban më shumë informacion dhe kryesisht:

- Ftesën dhe axhendën e takimit;
- Përmbledhjen/broshurën për pjesëmarrësit;
- Materialin prezantues (PoëerPoint);
- Procesverbalin (minutat e takimit);
- Listën e firmosur nga pjesëmarrësit;
- Foto nga takimi.

Si fillim, Bashkia ka përpiluar dhe ka shpallur publikisht (në faqen zyrtare të Ëeb-it të Bashkisë si dhe në Njësitë Administrative përkatëse), Kalendarin e Dëgjesave Publike për çdo Drejtori të Bashkisë, sipas Programeve respektive që do të zbatohen për periudhën 2026-2028.

Gjithashtu, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes në dëgjesat publike, të gjitha palët e interesuara (aktorët publik/privat) u njoftuan edhe në rrugë zyrtare dhe në formë elektronike lidhur me qëllimin e dëgjesës publike, axhendën si dhe materialin analitik shpjegues për çdo program zhvillimi. Për më tepër, çdo dëgjesë publike u pasqyrua nëpërmjet komunikatave të njëpasnjëshme për shtyp.

Për realizimin në kohë dhe me efikasitet të dëgjesave publike, Sektori i Analizës së Statistikave dhe Planifikimit Afatmesëm në Drejtorinë e Buxhetit pranë Bashkisë Durrës, asistoi çdo drejtori lidhur

me përpilimin dhe shpërndarjen e ftesave (në rrugë zyrtare dhe formë elektronike), axhendës si dhe përgatitjen e materialeve dhe prezantimeve sipas programeve. Gjithashtu, ky sektor, organizoi dhe të gjithë procesin e organizimit në terren dhe protokollimit të minutave të dëgjësive publike.

Në çdo dëgjese publike, pjesëmarrësit u informuan nëpërmjet prezantimeve dhe broshurave mbi investimet, projektet dhe shërbimet kryesore për secilën nga Programet që Bashkia ka parashikuar të zbatohet për periudhën e buxhetimit 2026-2028, si më poshtë vijon:

- Programi “Investimet në Infrastrukturën Rrugore dhe Transportin Publik”;
- Programi “Shërbimet Sociale”
- Programi “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”;
- Paketa Fiskale

Çdo dëgjese u drejtua nga drejtorët e menaxhimit të çdo programi. Pjesë e rëndësishme e këtyre dëgjësive ishin dhe përfaqësues të komisioneve respektive të Këshillit të Bashkiak të Bashkisë Durrës, OJF-ve të cilat aderojnë me projekte të ndryshme, si Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Durrës, të cilat aktualisht në kuadrin e: “Përmirësimit të procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje” ka bashkëpunuar me Bashkinë Durrës, për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit, , ku cdo qytetarë shpreh preferencat dhe sugjerimet e tij për prioritetet në Buxhetin e Bashkisë Durrës, propozimet e të cilëve, iu përcollën dhe Këshillit Bashkiak.

Propozimet nga qytetarët dhe grupet e interesuara u sistemuan sipas emërtimeve të programeve, duke vecuar kërkesat për investime.

Mbi bazën e tyre drejtorët e menaxhimit të çdo programi:

- do të zgjedhin ato projekte, të cilat përputhen me politikat sipas strategjisë së zhvillimit,apo ato që janë emergjente,
- do të përgatiten për diskutimin dhe përzgjedhjen e tyre nga grupi për buxhetimin strategjik,
- do të marrin miratimin nga kryetari dhe do të reflektohen në draftin e dokumentit të PBA të rishikuar 2026-2028.
- për projektet e vitit të parë të PBA-s, fillon përgatitja e fishave dhe tabelave sipas modelit të Ministrisë së Financave.

Bashkia do të vlerësojë edhe propozimet qytetare që lidhen me përmirësimin e shërbimeve dhe komunikimin e informimit më të mirë të tyre gjatë procesit të buxhetimit dhe për çështje të veçanta.

Përmbledhja e Dëgjësive Publike sipas Programeve për PBA 2026-2028

Sipas Kalendarit të Dëgjësive Publike të hartuar për Programin Buxhetor Afatmesëm PBA 2026-2028, u organizuan 24 Dëgjesa Publike në të gjitha Nj/Administrative të Bashkisë Durrës, sipas programeve si më poshtë:

- Programi i Projekteve dhe Infrastrukturës Publik Publike 6 Dëgjesa
- Programi mbi projektet e Shërbimit Social Publike 6 Dëgjesa
- Programi Arsimit parashkollorë dhe parauniversitar (investime) Publike. 6 Dëgjesa
- Paketa Fiskale 6 Dëgjesa

Dëgjesat sipas programeve dhe grupimeve paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Dëgjesat sipas programeve dhe grupimeve	Nr.Degjesave
Programi i Projekteve dhe Infrastrukturës Publike	6
Programi i Shërbimeve Sociale	6
Programi i Arsimit parashkollor dhe ai parauniversitar (investimet)	6
Paketa Fiskale	6
Totali	24

Njësitë Administrative	Numri i pjesmarrësve	Rekomandimet nga pjesmarrësit
Nj.A Manëz-Ishëm	54	11
Nj.A Sukth-Katundi Ri	55	12
Nj.A Nr.5 (Plazh-Shkozë)	26	3
Nj.A Nr.4 dhe 6 (Spitall-Kënetë)	37	3
Nj.A Nr. 1, 2 dhe 3	42	4
Nj.A Rrashbull	28	7
Total:	242	40

Në këto 24 Dëgjesa Publike, morën pjesë rreth 242 pjesëmarrës, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e Bashkisë.

Gjatë organizimit të këtyre Dëgjesave Publike, u diskutua për investimet, shërbimet dhe projektet sipas programeve që ka kryer Bashkia si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e dala nga pjesëmarrësit.

Numri në total i rekomandimeve të dala nga këto Dëgjesa Publike është **40** rekomandime.

KAPITULLI 2

2. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE

REKOMANDIMET E DALA NGA DËGJESAT PUBLIKE

➤ Njësia Administrative Manëz

1. Asfaltimi i Rrugës “Asllan Koçi” në Fshatin Borç.
2. Rikonstrukcion Kopshti në Fshatin Hamallaj.
3. Rikonstrukcion i rrugëve “Vora dhe Qyra”
4. Asfaltimi i rrugës së “Xhamisë dhe Thanishtes” në fshatin Armath.
5. Asfaltimi i Rrugës “Takaci dhe Stanit” në Armath.
6. Hapjen e një qendre shërbimi multifunksionale.

➤ Njësia Administrative Ishëm

7. Rikonstrukcion i Rrugës “Berbere” në Fshatin Gjuricaj.
8. Rikonstrukcion Rruga “Fushë Bizë”.
9. Asfaltimi i Rrugës “Tarini”.
10. Asfaltimi Rruga “Karep” në fshatin Kërtushaj.
11. Asfaltimin e rrugëve të lagjes në Fshatin Drac.

➤ Njësia Administrative Sukth

12. Rikonstrukcioni i Shkollës “Pal Zefi” në Rrushkull
13. Pajisjen e rrugëve me trotuare.
14. Pastrami i kanalet e II dhe III në Fshatin Rrushkull dhe Sukth.
15. Asfaltimi i rrugës “Paqja”.
16. Ndriçimin e rrugës nga Lagja 1 në Lagjen 6 në Sukth
17. Asfaltimin e rrugëve në Lagjen 5 dhe 6 në Sukth.

➤ Njësia Administrative Katund i Ri

18. Rikonstruksion “Ura e Shënepremte”.
19. Sistemimin e kanalit përgjatë murit rrethues të Shkollave:
 - I. Shkolla “Jusuf Hoti“ në Katund të Ri,
 - II. Shkolla ”Artan Zeka“ në Qerret dhe
 - III. Shkollës 9- vjeçare në Katund Sukth.
20. Asfaltim Rruga”Malësia”, Rruga”Ranore”, Rruga”Deda”.
21. Asfaltim Rruga”Azbardh” në Fshatin Qerret.
22. Rehabilitim i rrugës të Qendrës Shëndetësore në Katund të Ri.
23. Rehabilitimi i argjinaturës së Lumit Erzen në pjesën e Katundit të Ri.

➤ **Njësia Administrative Rrashbull**

24. Pastrimi i kanaleve të II dhe III në Romanat.
25. Ndriçimi i rrugës në Romanat dhe Xhafzotaj.
26. Ndriçimi i rrugës afër Shkollës”Vëllezërit Haradinaj”.
27. Rehabilitimi i kanaleve tek pallatet 5-katëshe në Fshatin Xhafzotaj.
28. Asfaltimi i rrugës nga Shkolla”V.Haradinaj” tek Shkolla”M.Hida” në Arapaj.
29. Asfaltimi i Rrugëve:”Lahuta”,”Donika Kastrioti“ në Arapaj,”Akropoli“ në Rrashbull.
30. Ndërtimin e një këndi lojërash për fëmijë.

➤ **Njësia Administrative 5**

31. Asfaltimin e Rrugës”Japigia” dhe Rruga”Begatia“
32. Ndriçimin e Rrugës”Rrota e Kuqe“.
33. Asfaltimin e rrugicave midis dy rrugëve paralele, Rrugës “Përparimi“ dhe Rruga “Kepi i Rodonit”.

➤ **Njësia Administrative 4, 6**

34. Rikonstruksion i Rrugës”235” në Nj.A.4
35. Asfaltim i Rrugës”Kastrioti”,”Hipodromi”,”Isuf Ferra“ në Nj.A.4.
36. Asfaltimi i Rrugëve:”Enver Kotorri”,”Vincens Prenushi”,”Palush Tati” dhe “Dita e Diturisë” në NJ.A.6

➤ **Njësia Administrative 1, 2, 3**

37. Rikonstrukcion i fasadës dhe tarracës së Pallatit 300 në Lagjen 12 pasi tarraca e këtij pallati është amortizuar dhe është duke rënë në trotuar duke rrezikuar jetën e qytetarëve.
38. Zgjidhja e problemit të përmytjeve në Rrugën "Hysen Kërtusha" dhe "Hysen Myshketa".
39. Vendosja e stolave dhe e koshave të mbeturinave ne Lagjet: 12,5,16.
40. Asfaltimi i rrugicës brenda bllokut të pallateve që lidh Rrugën "A.Durrsaku" me Rrugën "Epikadeve".

Në total janë evidentuar **40 rekomandime konkrete** për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve."

KAPITULLI 3

3. PROCESVERBALET E DEGJESAVE PUBLIKE

Proçes verbalet e të gjitha takimeve të zhvilluara për Dëgjesat Publike 2026-2028

Sipas kalendarit të Dëgjesave Publike 2026-2028, takimet u zhvilluan në muajin Shtator – Tetor 2025, si më poshtë:

1. Takimi në Manzë, për Njësitë Administrative Manzë dhe Ishëm (data 29.09.2025).
2. Takimi në Sukth, për Njësitë Administrative Sukth dhe Katund i Ri (data 30.09.2025).
3. Takimi në Plazh, për Njësitë Administrative 5 (data 01.10.2025).
4. Takimi në Spitalë, për Njësitë Administrative 4 dhe 6. (data 02.10.2025).
5. Takimi në Rrashbull, për Njësitë Administrative Rrashbull. (data 03.10.2025).
6. Takimi në Durrës, për Njësitë Administrative 1,2,3. (data 06.10.2025).

Dëgjesa I

Data 29.09.2025

Vendi i takimit: Bar-Restorant "Sami Hoxha", Manzë.

Kohëzgjatja: 150 minuta

Në këtë takim, kishte një pjesmarrje të gjërë, ku të pranishëm ishin përfaqësues të komunitetit të Njësiave Administrative Manzë dhe Ishëm, përfaqësues të grupeve të interesit, Institucioneve Arsimore, OSHE, Emergjencë Civile, OJF që operojnë në këto Nj.A.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës ishin 54 persona.

Në takim u prezantuan këto programe:

- Programi i Arsimit parashkollor dhe parauniversitar në arsim për PBA 2026-2028.
- Programi i Projekteve dhe Infrastruktura Publike për PBA 2026-2028.
- Programi mbi Projektet e Sherbimit Social për PBA 2025-2027.
- Paketa Fiskale 2026

Takimin e hapi ZV/Kryetari Z. Elio Jani, i cili gjatë fjalës së tij përshëndetëse prezantoi investimet e realizuara gjatë vitit 2025, duke përfshirë investimet në infrastrukturë rrugore dhe arsimore.

Më pas, degjesa vazhdoi me prezantimet e drejtorëve të drejtorive dhe përfaqësuesëve përkatës për katër programet buxhetore të PBA 2026-2028. Disa nga objektivat kryesore për periudhën 2026-2028 përfshijnë:

- Shkolla Mesme Bashkuar "Rexhep Mezini", NJA Ishëm/Perfundon ne Tetor 2025
- Rikonstruksion i Njesise Administrative Ishem
- Ndërtimin e markatës për tregtimin e produkteve bujqësore në Manëz
- Rikonstruksion Gjumnazit "Manez"
- Rikonstruksion i Rrugës Gjumnazi Manëz
- Rikonstruksionin dhe rindërtimin e qendrave shëndetësore
- Krijimin e hapësirave publike dhe këndeve të lojërave për fëmijët
- Shtrimin e disa rrugëve, përfshirë Borces, Hoxhëve,Vora, Kodrashit dhe Ferhati, si prioritete për vitet e ardhshme

Pas prezantimeve, banorët dhe të pranishmit diskutuan rreth prioriteteve të identifikuar, duke dhënë mendime, duke parashtruar ankesa dhe sugjerime për përmirësimin e shërbimeve dhe investimeve në komunitet.

Pyetje dhe Diskutime

NJ.A.Manëz dhe Ishëm.

1. Banorë Fshati Manëz - Taksat dhe tarifave vendore për familjet të shpërndahen tek UKD çdo muaj dhe jo disa muaj bashkë pasi nuk përballojnë dot vlerat e larta mujore.

Përfaqësues i DTTV: UKD është Agjenti jonë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare për shkak të disa problemeve në ndërlidhjen e sistemit është dashur të mbledhen disa muaj bashkë por në vitin e ardhshëm kjo gjë do të sistemohet.

2. Anxhela Kordinatore CDS Durrës- Çfarë do të bëhet me Bibliotekën e Durrësit, mund të krijohet mundësia për hapjen e një biblioteke në njësinë Manëz?

Drejtori i drejtorisë së arsimit: njësisë Administrative Manëz i vjen në ndihmë biblioteka e shkollës.

3. Anxhela Kordinatore CDS Durrës - Çfarë do të bëhet me subvencionet e fermerëve.

ZV/Kryetari E.Jani: Është projekt i Qeverisë Shqiptare.

4. Diana(Përfaqësuese e Lulet e Pranverës)- Kopshtet, shkollat janë të mira por kam një kërkesë për hapjen e një qendre të të moshuarve dhe për fëmijë me zhvillim të vonuar.

ZV/Kryetari E.Jani: Do të marrim në konsideratë.

5. Lulëzim Dema- Kopshti Kameronit ka qenë prioritet por pse nuk do të bëhet?

Përfaqësues i Drejtorisë së Projekteve - Kopshti nuk është rikonstruktuar sepse fëmijët janë transferuar në Shkollën “Riza Shera” në Radë.

6. Banor në Hamallaj - Fshati Hamallaj ka një kopsht me 12 fëmijë dhe nuk është rregulluar dhe i çojnë fëmijët në një banesë familjare. Rruga e Hamallës nuk ka investime në Vora dhe Qyra.

ZV/Kryetari E.Jani: Janë bërë shumë rrugë të tjera ndërkohë këto janë prioritet për të ardhmen.

ZV/Kryetari E.Hoxha - Janë bërë investime dhe në energjinë elektrike.

7. Banor Fshati Borç- Rruga është e keqe dhe nuk kalon dot makina.Manza ka problem emergjent varrezat.

ZV/Kryetari E.Jani - Projekti është në fazë finale dhe shumë shpejt ky problem do të zgjidhet, është drejt përfundimit.

8. Banor-Problem është edhe uji i pishëm. Vjen vetëm 10 minuta në ditë. Janë katër rrugë në Armath që kanë nevojë të asfaltohen, Rrugët:“Thanishte, Xhamisë, Takaci dhe Stanit“

ZV/Kryetari E.Jani: Do të jemi në ndihmë të komunitetit. Do jua bëjmë me dije këtë problem.

9. Kryeplak në Ishëm- Kemi problem emergjent shtrimin e disa rrugëve në fshatra:

- Rrugës”Berbere” në Fshatin Gjericaj.
- Rruga”Fushë Bizë”.
- Rrugës”Tarini”.
- Rruga”Karep” në fshatin Kërtushaj.
- Rrugeve të lagjes në Fshatin Drac.

ZV/Kryetari E.Jani: Faleminderit, do e kemi parasysh në buxhetin e ardhshëm. Nëse nuk ka ndonjë pyetje tjetër këtë dëgjese e quaj të mbyllur. Faleminderit.

Dëgjesa II

Data 30.09.2025.

Vendi i takimit: Kompleksi “Bushmani”, Sukth.

Kohëzgjatja: 150 minuta

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 55 persona.

Në takim u prezantuan këto programe:

- Programi i Infrastrukturës Rrugore dhe Investimet Publike për PBA 2026-2028
- Programi i Arsimit Parashkollor dhe Parauniversitar
- Programi i Strehimit dhe Shërbimit Social
- Paketën Fiskale

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:

Përshëndetje të gjithëve. Sot jemi në ditën e dytë të zhvillimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2026-2028. Në këto dy Njësi Administrative, ne kemi përfunduar me sukses disa investime por kemi të tjera në proces, të cilat do të përmenden në këtë prezantim. Në fund të prezantimit të katër programeve, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e tre programeve buxhetore për PBA 2025-2027, të cilët u prezantuan nga përfaqësuesit e cdo Drejtorie të Bashkisë Durrës.

U prezantuan investimet në infrastrukturë publike dhe rrugore me Buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2026-2028

- Ndërtimin e Shkollës 9 vjecare “Vadardhë”,
- Ndërtimin e Qendrës Shëndetësore Vadardhe,
- Rikonstruksionin e Njesisë Administrative Sukth dhe Katund i Ri,
- Ndërtimi i Qendrës së Strehimit dhe Trajtimit të kafshëve
- Ndërtimin e Kompleksit Sportiv në Katundin e Ri,
- Përmirësimin e infrastrukturës së varrezave,
- Pastrimin e kanaleve kulluese
- Rikonstruksion i rruges “Ylli i kuq dhe Fierza”
- Rikonstruksion i rruges “PAQJA”
- Rikonstrksion “Ura Jubë”
- Ndërtimin e rrugëve të fshatit Kullë, Hamallaj Hidrovor, Rrugën Gjergj Meta Rushkull dhe rrugët në lagjet 1-6 Vardardhë ndërsa në Njësinë e Katundit të ri Rrugën Vau Rrjasës, Lisakëve, Lëvizja e lirë-Domaj dhe rruga Vain.

Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

NJ.A. Sukth dhe Katund i Ri

1. Kryeplak Vardardhë

- Kanalizimet e II dhe të III janë pa pastruar dhe sjellin përmytje.
- Qendra Shëndetësore në Sukth ka përmytje.
- Në Rrugën Sukth-Manëz të vendosen policë të bashkisë pasi është bërë burim aksidenti.
- Të ndërtohen trotuare për fëmijë, mungojnë trotuaret.
- Të bëhet shtrimi i urës Shënepremte që lidh fshatrat me njëri tjetrin.
- Ndriçim në Rrugën tek autobuzat në Sukth nga Lagjia 1 deri Lagjia 6 pasi janë fëmijët pasdite.
- Lagjia 5 dhe 6 duhet bërë shtrimi i rrugës i cili nuk është futur në projekt.
- Njësia Administrative Sukth të bëhet Bashki se ka shumë banorë.

2. Kryetar Rrushkull

- Së pari asnjë investim nuk është bërë për zonën tonë, kanalet e II dhe III janë të pa pastruara, pallatet në fshat nuk janë rikonstruktuar, nuk kemi as ndriçim.
- UKD ka prishur asfaltin dhe ka dëmtuar tubat, kemi ngelur pa ujë.
- Shkolla 9-vjeçare Pal Zefi nuk ka investim duhet rikonstruktuar.
- Kanalizimet e ujrave të zeza nuk po bëhen, ndërkohë kanë sjell tubacionet.
- Nuk ka trotuare.
- Policia Bashkiake nuk është prezente.

3. Kryeplaku i fshatit Qerret

- Për kanalizime nuk është bërë asnjë gjë.
- Ndriçimi ekzistues por nuk ndryshojnë llampat.
- Rruga e lagjes është e pa rregulluar rreth 500 metra rrugë.
- Kanali që është jashtë murit të shkollave të reja që janë ndërtuar është pa sistemuar dhe koshat e mbeturinave rrijnë në rrugë, për të tre shkollat,“Jusuf Hoti“,“Artan Zeka“,dhe shkolla në Katund Sukth.
- Shtrimin e rrugës“Asbardh“ në fshat.

ZV/Kryetari E.Jani: Bashkia me fondete veta ka bërë investime në këtë zonë por në vijimësi planifikojmë sipas fazave përkatëse të bëhen investime të tjera referuar problematikave tuaja. Njësia ka për detyrë menaxhmin për çdo problematikë, shpresojmë që kryetari i ri i njësise ti japi zgjidhje problemeve tuaja.

4. Banore – Kanë kaluar 6 vite nga tërmeti dhe akoma nuk kemi një komunikim se çfarë do bëhet me shtëpinë time të shkatërruar nga tërmeti, ka rënë çatia në dysHEME, nuk më përgjigjet asnjë njeri nga bashkia. Kemi kërkuar disa herë asfaltimin e rrugës“Paqa“.

ZV/Kryetari E.Jani: Duhet të shkosh te zyra e Rindërtimit, ndërkohë komunikoj dhe me kryetarin e njësise që të na e bëjë prezente problemin.

5. Banor Lagjia 5- Nuk është marrë asnjë masë për rrugën, kanalizimet janë të prishura, dalin në rrugë ujërat e zeza. Tek pazari bëhen aksidente sepse nuk ka rrugë. Kryeplaku duhet të bëjë problem gjithë ankesat tona dhe nuk i bënë prezente. Problem janë edhe insektet, nuk bëhet dizifektimi i tyre. Rruga në Qendrën Shëndetësore duhet rregulluar, janë dhe tre rrugë për asfaltim:“Malësia“,“Ranore“,“Deda“.

ZV/Kryetari E.Hoxha : Për zgjidhjen e duhur duhet të drejtoheni kryetarit të njësise.

6. Banor Lagjia 5: Nuk kemi ujë, kanalet janë të papastruara, dritat e rrugës janë të djegur. Ju lutem merrni masa për të shtruar rrugën.

7. Kryeplaku Katund i Ri:

- Argjinatura e Lumit Erzen ka ngelur përgjysëm tek Katundi i Ri dhe është një problem shumë emergjent.
- Dy kanale të rrugëve të K.Ri duan t’i mbyllin pasi dalin ujërat e zeza. Janë 5-6 shtëpia që kanë kanalet që i derdhin para fshatit sepse nuk kanë kanalizime.
- Këshilli islamik te shkolla e vjetër janë 60 mësues që duan të ndërtojnë një shkollë islamike dhe duan të kërkojnë leje me fondet e veta.

ZV/Kryetari E.Jani: Proçedura e ndërtimit të shkollës ka proçedurë ligjore dhe të interesuarit për projektin duhet të aplikojnë në bashki. Çdo problematikë që keni komunikojeni me kryetarin e ri.

ZV/Kryetari E.Hoxha: Të gjithë problemet vijani në dijeni kryetarit dhe ne do mbetemi në kontakt të vazhdueshëm për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Dëgjesa III

Data 01.10.2025.

Vendi i takimit: Ambjentet e shkolles “B.Curri”, Plazh, Durres.

Ora: 10^{oo}-14^{oo}

Kohëzgjatja: 90 minuta

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 26 persona.

Takimin e hapi Nënkryetari i Bashkisë, z. Elio Jani, i cili theksoi:

“Sot zhvillojmë dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2026-2028 për Njësinë Administrative Nr. 5. Do të paraqesim një panoramë të investimeve të realizuara në këtë njësi, si dhe projektet e reja që do të zbatohen në harkun kohor 2026-2028. Në përfundim të prezantimit të katër programeve, do të kemi mundësi të bashkëbisedojmë me qytetarët për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.”

Pas fjalës hyrëse, dëgjesa vazhdoi me prezantimin e investimeve konkrete në infrastrukturën publike dhe rrugore, të parashikuara me Buxhetin 2025 dhe PBA 2026-2028, ndër të cilat:

- Rikonstruksioni i Rrugës “Adria”
- Rikonstruksioni i Shkollës “B. Curri”
- Rikonstruksioni i Godinës së Banimit “VIKO”
- Rikonstruksioni i sheshit midis pallateve, Rruga “Qafë Botë”, Plazh
- Rikonstruksioni i Rrugës “Xhevdet Hafizi”, Plazh
- Rikonstruksioni i Rrugës “Pjetër Budi”
- Rikonstruksioni i Rrugës “Pallatet e Nish Cigares”, Nishtulla

Në përfundim të prezantimeve, banorët dhe të pranishmit në sallë morën fjalën, duke diskutuar mbi prioritetet e paraqitura dhe duke dhënë mendimet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

Njësia Administrative Nr.5.

1. Kujtim Mezani (pensionist):
 - Problem me energjinë elektrike në shkollë,
 - Rruga Japigia dhe Rruga e Begatisë duhen të asfaltohen.

- Shkolla ka nevojë për rikonstruktion.

ZV/Kryetari E.Jani: Do t'i rishikojmë. Shkolla është në plan të rikonstrukturohet.

2. Banor i Lagjes së Plazhit:

- Rruga Rrota e Kuqe është në gjendje të keqe nga kanalizimet,
- Mungon ndriçimi nuk zëvendësohen llampat,
- Telat që varen më rrugë janë problem për banoret.
- Një zonë mes pallateve që ka nevojë të shtrohet, ndërkohë që është pranë vijës së detit në pjesën e Rrotës së Kuqe.

ZV/Kryetari E.Jani: Faleminderit, në plazh ka ndryshim rrënjësor por kërkesa juaj do shikohet, ju presim në Bashki për të biseduar më nga afër. Prandaj jemi këtu sot, që t'ju dëgjojmë në lidhje me problemet e mundshme që keni.

3. Banor: Problemi i legalizimit të shtëpive për zonën e plazhit.

ZV/Kryetari E.Jani: Kjo nuk është në kompetencën tonë por do e paraqesim si shqetësim.

4. Banor: Jemi disa familje që kemi shtëpitë tona në një rrugice që lidh Rrugën "Përparimi" me Rrugën "Kepi i Rodonit", janë disa rrugica brendave këtyre dy rrugëve paralele me njera-tjetrën që përmbysen gjatë shirave.

ZV/Kryetari E.Jani: Do ta marrim në konsideratë, faleminderit.

Dëgjesa IV

Data 02.10.2025.

Vendi i takimit: Palestra e shkolles "Naim Babameto", Spitallë, Durrës.

Kohëzgjatja: 120 minuta.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 37 persona.

Dëgjesa Publike u drejtua nga Nënkryetarët e Bashkisë, z. Elio Jani dhe z. Egert Hoxha, si dhe nga përfaqësues të programeve buxhetore.

Takimin e hapi Nënkryetari i Bashkisë, z. Elio Jani, i cili theksoi:

"Sot zhvillojmë dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2026-2028 për Njësinë Administrative Nr. 4 dhe Nr.6. Do të paraqesim një panoramë të investimeve të realizuara në këtë njësi, si dhe projektet e reja që do të zbatohen në harkun kohor 2026-2028. Në përfundim

të prezantimit të katër programeve, do të kemi mundësi të bashkëbisedojmë me qytetarët për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.”

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e katër programeve buxhetore për PBA 2026-2028, të cilët u prezantuan nga përfaqësuesët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.

U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2026-2028:

- “PARKU URBAN” Spitallë konsiston në mbylljen e kanalit të ujërave të larta në zonën e Spitallës (1300 ml) dhe shndërrimin e zonës në një ‘Park Urban linear’ (3-4 ha) ku do të krijohet një kurorë e gjelbër me mbjelljen e pemëve, do të ndërtohen fusha sportive, kënde lojërash për fëmijë si edhe hapësira rekreative për të gjitha grup-moshat.
- Rikonstruksioni i Shkollës “Met Hasa”,
- Rikonstruksioni i Nj.A. Nr.4,
- Rikonstruksioni i Rrugës “Llogara”, Spitalle,
- Rehabilitim i Kanalit të Ujërave të Larta Spitallë - Porto Romano.

Në përfundim të prezantimeve, banorët dhe të pranishmit në sallë morën fjalën, duke diskutuar mbi prioritetet e paraqitura dhe duke dhënë mendimet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

Njësia Administrative Nr.4 dhe Nr.6.

1. Banor Lagjia 15- Tërmeti më ka dëmtuar banesën dhe situata është akoma e njejtë, nuk është bërë asnjë gjë. Jam DS4, është shëmbur komplet ndërtesa, u bën 6 vite dhe nuk ka ndryshuar situata. Jam pa banesë. Kam 6 vjet me qera dhe nuk i gatshëm financiarisht.
2. Markola Anëtar KB i Spitallës- Banesa e zotërisë që sapo foli është në procedurë.
 - Rruga 235 nuk është marrë akoma asnjë masë dhe është në kushtee të këqija.
 - Zona është zhvilluar shumë por ju lutem merrni në konsideratë shqetësimet e qytetarëve në lidhje me përmytjet.
 - Zbukurimet në fund të vitit të bëhen pjesë edhe të kësaj zone jo vetëm qëndra.
 - Përmytjet në të gjithë zonën janë problematike.
 - Janë disa rrugë që kanë nevojë të shtrohen në Nj.A. 6 : “Enver Kotorri”, “Vincens Prenushi”, “Palush Tati” dhe “Dita e Diturisë”.

ZV/Kryetari E.Jani: Zotëria ka të drejtë, pas 6 vitesh për DS4 ka problematike pjesën procedurale dhe fondit. Bashkia strehon 936 familje. Kemi ngelur prapa për pjesën e sahateve në mungesë nga OSHE. Fondet e tërmetit janë vënë në dispozicion të qytetarëve. Në Spitallë një pjesë e mirë e rrugëve janë shtruar. Shkollat janë të reja dhe janë bërë investime të rëndësishme. Fondet e Bashkisë ndahen sipas planeve. Ne jemi para Projekt- Buxhetit për t’ju dëgjuar në lidhje me problematikat që keni.

3. Banorë- Kam 6 vjet që nuk marrim bonus dhe çelsat e shtëpive nuk i kemi marrë akoma. Jemi shumë të irrituar dhe nuk paguajmë dot qeranë.

ZV/Kryetari E.Jani: Në fund të muajit do të merrni çelsat.

4. Banorë- Kërkoj një zgjidhje për përmytjet sepse po më prishet shtëpia. Kanalet e ujrave të zeza janë të hapura. Të 3 kanalet janë të bllokuara. Janë tre rrugë që akoma s’është bërë ndonjë investim, “Kastrioti”, “Hipodromi” dhe “Isuf Ferra”.

ZV/Kryetari E.Jani: Jemi në procedurë mbi një projekt për të marrë masa për pastrimin e pusetave dhe kanaleve. Me masat që po marrim kjo situatë nuk ka për t’u përsëritur.

ZV/Kryetari E.Hoxha: Stacionet e pompimit N. 9 janë vënë në punë nga UKD. Qeveria Franceze ka bërë një projekt që do të përfshijë këtë zonë. Kanalet janë duke u pastruar deri në zonën e Hidrovorit.

5. Admir Shehu Lagjia 15- Rruga 235 është pa asfaltuar dhe pas vendosjes së tubave që janë vënë keq, janë mbledhur mbeturina. Rruga Laguna dhe Pinc Vidi ku me vendosjen e tubave do bëhen problem përmytje.

ZV/Kryetari E.Jani: Do ta shohim dhe do e verifikojmë.

6. Banorë Lagjia 6- Jamë pensionist dhe më është prishur shtëpia, nuk kam ndihmë dhe jam me qera dhe nuk përballojë dot asnjë lloj ndihme.

ZV/Kryetari E.Jani: Ne presim një VKM për pjesën e si procedurë ligjore. Shumë shpejt do të dali VKM-ja. Në lidhje me ndihmën ekonomike pas mbarimit të dëgjësave do të flisni me Arlindin përfaqësuesin e Drejtorisë së shërbimeve sociale.

Dëgjesa V

Data 03.10.2025.

Vendi i takimit: Kompleksi “Mergimi”, Rrashbull.

Ora: 10⁰⁰-14⁰⁰

Kohëzgjatja: 150 minuta

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 42 persona.

Dëgjesa Publike u drejtua nga Nënkyetarët e Bashkisë, z. Elio Jani dhe z. Egert Hoxha, si dhe nga përfaqësues të programeve buxhetore.

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:

“Jemi në ditën e pestë të zhvillimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028. Gjatë këtij takimi do të paraqitet një panoramë e investimeve të realizuara në Njësinë Administrative Rrashbull, si dhe projektet e reja që parashikohet të zbatohen në periudhën 2026-2028. Në përfundim të prezantimit të tre programeve, do të zhvillohet një bashkëbisedim me ju për të dëgjuar mendimet, kërkesat dhe sugjerimet tuaja”.

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e katër programeve buxhetore për PBA 2026-2028, të cilët u prezantuan nga përfaqësuesit e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.

U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2026-2028 si më poshtë:

- Rikonstruksion i Njesisë Administrative Rashbull,
- Rikonstruksion Rruga "Hoxheve" Njesia Administrative Rrashbull, Arapaj
- Rikonstruksion Rruga “Shaliante”, Shenvlash, Rrashbull
- Sistemim K.U.B Në Rrugën "Eqerem Çabej", Arapaj
- Përmirësimi i Infrastrukturës së Varrezave
- Pastrimi i Kanaleve prej 10'470ml

Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioritetëve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

Njësia Administrative Rrashbull

1. Banor- Jam në një zonë që nuk ka pas asnjë investim, mungesë uji. Nuk ka ndriçim rruge dhe rruga është e pa strukturuar.

ZV/Kryetari E.Jani: Faleminderit.

2. Kryetar Fshati Rrashbull- Në Rashbull janë bërë goxha investime, si në rrugë ashtu edhe në ndriçim dhe pastrim.

ZV/Kryetari E.Hoxha Jemi këtu për të dëgjuar kërkesat tuaja, për të investuar për të ardhmen.

ZV/Kryetari E.Jani: Në Rashbull janë bërë investime të mëdha. Sot në fakt jemi këtu për të mbajtur shënim dhe dëgjuar problematikat tuaja.

3. Kryeplak Fshati Romanat: Kanalet e II dhe III nuk janë bërë pjesë e ndërhyrjeve për tu pastruar. Në rrugë nuk ka ndriçim as në Romanat as në Xhafzotaj, kemi bërë kërkesë tek Administratori dhe nuk është përgjigjur.

ZV/Kryetari E.Jani: Bashkë me kryetarin e ri e njësisë duhet të paraqiteni në Bashki. Paraqituni ditën e hënë tek Drejtoria e Projekteve.

4. Kryeplak Shënavlash- Tek zona jonë rrugët janë me gunga duhen sistemuar.
5. Pëllumb Prençi- Kemi një kanal në Rreshbull që vjen nga kodra dhe duhet të pastruar. Rruga nga shkolla nuk është e mirë, duhet shtruar, dritat nuk ndizen, kanalet e ujrave të zeza të kodrës shkarkohen tek ne. Brënda mundësive nga ura e varrezave deri këtu të bëhet një investim.

ZV/Kryetari E.Jani: Po mbajmë shënime, faleminderit për kërkesën tënde.

6. Ibrahim Hoxha banor Rrashbull- Problemi i legalizimit të pronave, po vinë vërdallë dhe nuk po marrim zgjidhje. Policia më ka prishur shtëpinë. Rruga "Akropoli" ka nevojë të shtrohet.

ZV/Kryetari E.Jani: Bashkia nuk ka kompetenca dhe bazë ligjore të merret me pronat. Drejtohuni gjykatës.

7. Kryetar Xhafzotaj- Janë 4 pallate 5 katëshe që nuk funksionon asnjë kanal dhe aty nuk ka mundësi ku të kalohet sepse përmytet. Terrenet sportive nuk kanë filluar të ndërtohen.

ZV/Kryetari E.Jani: Faleminderit.

8. Anxhela Meta- Kamë disa sygjerime në lidhje me shtrimin e rrugës nga Shkolla "V.Haradinaj" tek Shkolla "M.Hida" në Arapaj.
9. Banor i fshatit Rrashbull- Kemi një rrugë që kemi bërë vet dhe ndërkohë është përmytur dhe nuk kalohet dot, Rruga "Lahuta", ka nevojë të shtrohet dhe rruga "Donika Kastrioti". Mirë do ishte sikur të ndërtohej edhe një kënd lojërash për fëmijët.

ZV/Kryetari E.Jani: Po ju bëj një thirrje që për të gjitha problematikat t'i drejtoheni administratorit të ri të njësisë. Besoj se me Fiqiriu do t'i zgjidhni të gjitha problemet tuaja.

Dëgjesa VI

Data 06.10.2025.

Vendi i takimit: Ambjentet e shkolles "Jan Kukuzeli" Durrës.

Ora: 10⁰⁰-14⁰⁰

Kohëzgjatja: 120 minuta.

Pjesmarrës në takim, sipas listë prezencës, 38 persona.

Dëgjesa Publike u drejtua nga Nënkryetarët e Bashkisë, z. Elio Jani dhe z. Egert Hoxha, si dhe nga përfaqësues të programeve buxhetore.

Takimin e hapi N/Kryetari i Bashkisë, Z. Elio Jani. Në fjalën e tij ai tha:

Përshëndetje të gjithëve. Sot jemi në ditën e fundit të realizimit të dëgjesave publike për buxhetin e vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 për Njësinë Administrative Nr.1,2,3 ku do tju prezantojmë investimet që janë bërë në këto njësi, gjithashtu do tju prezantojmë dhe projektet e reja që do të zbatohen përgjatë harkut kohor 2026-2028. Në fund të prezantimit të katër programeve nga përfaqësuesit e drejtorive, do të bashkëbisedojmë për të dëgjuar kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

Më tej dëgjesa vazhdoi me prezantimin e katër programeve buxhetore për PBA 2026-2028, të cilët u prezantuan nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse të Bashkisë Durrës.

U prezantuan objektivat për investimet në infrastrukturë rrugore në Projekt Buxhetin e vitit 2026-2028 si më poshtë:

- Rikonstruksion i Njësisë Administrative Nr.1
- Gjimanzi "Gjergj Kastrioti" dhe Siti Arkeologjik
- Rindertimi i Banesave Individuale në Rrugën "Dalip Peza"
- Fusha Sportive e Shkollës "Bernardina Qeraxhi"
- Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, për 1 banesë kolektive me Nr.32, Rruga "Teodor Rupi"
- Rikonstruksion i Rrugës "Kasem Durrësi"
- Rikonstruksion i Rrugës "Aleksandër Goga"
- Sistemim K.U.B. në Rrugën Taulantia, Lagjia Nr. 1
- Riforcimin e pallateve nga demtimi i tërmetit:

1. Pallati Nr. 16, rruga “Jahja Ballhysa, lagjja nr. 17, me kod gis 3102, Durrës
2. Pallatin Nr. 18 (901), rruga “Kristo Sotiri”, lagjja nr. 18, kod gis, 22378, Durrës
3. Pallati nr. 27, rruga “Dalip Peza”, lagjja nr. 17, kod gis 1484/1, Durrës
4. Pallati nr. 52, rruga “Hysen Kërtusha”, kod gis 23005, Bashkia Durrës
5. Pallati nr. 103, rruga “Aleksandër Goga”, lagjja nr.9, kod gis 24935, Bashkia Durrës
6. Pallati nr. 196, rruga “Pavarsia”, kod gis 5513, Bashkia Durrës
7. Pallati “Mustafa Pash Bushati”, rruga “Bajram Tusha”, lagjja nr. 14, kod gis 4911, Bashkia Durrës.

Pas prezantimit të këtyre programeve, fjalën e morën banorët dhe të pranishmit në sallë, të cilët diskutuan rreth këtyre prioriteteve, duke dhënë mendimet dhe duke parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Pyetje dhe Diskutime

Njësitë Administrative nr.1, nr.2 dhe nr.3.

ZV/Kryetari E.Hoxha: Faleminderit kolegëve për këtë prezantim, Bashkia Durrës ka realizuar Dëgjесat Publike në gjithë Njësitë Administrative. Presim kërkesat dhe sygjerimet tuaja.

1. Banor Lagjja 12- Pallati 300, kemi disa probleme me strukturën e pallatit, kat i parë është ndërtim i vjetër dhe ka shumë probleme. Bashkia ka bërë vetëm lysterje dhe familjarët kanë mbushur një pjesë të tarracës. Pallati është i pasuvatuar dhe mungojnë shkarkimet. Pallati ka jashtë fasadës strehë rreth e qark që nga shtresa e tarracës bie poshtë por gjerësia e tarracës është e barabartë me gjerësinë e trotuarit. Rreziku është i madh. Në cepin e pallatit ka rënë një pjesë 3m nga sipër por pa dëme në njerëz por është rrezik për këmbësorët rreth e qark. Ka nevojë edhe për riparim.

ZV/Kryetari E.Jani: Faleminderit që ndave me ne shqetësimin tuaj. Ne do të mbajmë shënim shqetësimin tuaj dhe kolegët do ta shikojnë dhe të shohim mundësitë që kemi për ta rregulluar.

2. Banor: Lidhjet e internetit janë të rrezikshme.

ZV/Kryetari E.Jani: Kemi filluar një aksion për këto lidhje që do të bëhen për të gjithë Durrësin.

3. Banor: Nuk më vjen fatura e ujit së bashku me faturën e taksave dhe tarifave familjare në banesë dhe nuk kemi informacion mbi taksat.

Përfaqësues i DTTV: Vjen në faturën e ujit e shpërndarë për gjithë vitin.

Drejtor i DTTV: Nëse nuk vjen fatura e ujit pasi të mbarojmë dëgjuesën, do t'i japim një zgjidhje problemit tuaj, do të komunikojmë me agjentin tonë dhe do tju ndihmojmë.

4. Banore Lagjia 12:

- Para 5 viteve arritën të rregulloshin ndriçimin por tek Rruga Abaz Çelkupa nuk ka ndriçim duhen zëvendësuar llampat nga zona e Markates deri tek Kryqi i Kuq pasi janë të djegura.
- Pjesa e përmbytjeve, rasti i fundit aksidenti i fundit që ndodhi na shqetëson. në Rrugën”Hysen Kërtusha” dhe “Hysen Myshketa”.
- Ne lagjen 16 janë rregulluar depozitat ndërkohë që në lagjen 12 akoma nuk kanë filluar.
- Oshe ka prishur trotuarin dhe Bashkia nuk e ka rregulluar.
- Mungesë e stolave, koshave të mbeturinave në lagjen 12,16,5.

ZV/Kryetari E.Jani: Për sa i përket ndriçimit do dërgoj përfaqësues që ta kontrollojnë. Mund të bëni dhe ankesën tuaj. Projekti i depozitave do të vazhdojë edhe në lagjen 12.

ZV/Kryetari E.Hoxha: OSHE e ka për detyrë të bëjë për rrëgullimin e rrugës.

5. Banor- Keni planifikuar shtimin e shkollave, duhet ta planifikoni këtë gjë pasi ato janë të mbingarkuara. Fëmijët rrijnë nëpër banka nga 3 veta dhe ndjekin shkollën mbasdite. Si mendoni ju se do bëhen këto me frymën e shenjtë:

ZV/Kryetari E.Jani: Nuk kemi një përgjigje për sa i përket kësaj çështjeje.

6. Banor- Qendra Durrësi Aktiv:

- Kemi 6 vite që merremi me gjëndjen e kanaleve por problem vazhdon kanalizimet.
- Gjatë verës vjen një erë e keqe tek shëtitorja L.1.
- Tek lagjia e kalasë nuk ka ndriçim rruge, duhen zëvendësuar llampat .
- Në L.1 është një zonë me rrëzë ku mund të kthehet në vegla pune.
- Është një rrugicë brenda bllokut të pallateve që lidh dy rrugët:“A.Durrsaku” dhe“Epikadëve” ka nevojë të shtrohet se përveç banorëve i shërben dhe disa bizneseve.

ZV/Kryetari E.Jani: Kanalizimet e Lagjes 1 janë procedurë prokurimi dhe do të sistemohen në të tërë qytetin.

ZV/Kryetari E.Hoxha: Pas përmbytyjeve të fundit, kryetarja ngriti një grup menaxhimi për rregullimin dhe sistemimin e kanaleve.

Drejtor i DTTV: Shihni një mundësi për sensibilizimin e qytetarëve.

7. Mustafaraj Këshilltare Bashkie- Qytetarët të kenë një informacion mbi investimet dhe pastaj të bëjnë pyetjet. Një qytetar parashtron kërkesat dhe gjithmonë ka tendencë dhe jo bashkëpunime institucionale.

KAPITULLI 4

4. MATERIALET E PREZANTUARA

Gjatë zhvillimit të dëgjesave publike në kuadër të hartimit të Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, u prezantuan materiale për programet kryesore buxhetore të Bashkisë Durrës, me qëllim informimin dhe përfshirjen e publikut në procesin e planifikimit të politikave dhe prioriteteve të zhvillimit.

Materialet prezantuese përfshinin analizën e situatës aktuale, objektivat strategjike për periudhën 2026–2028, si dhe projektet dhe ndërhyrjet e planifikuara në secilin program.

Materialet u shoqëruan me prezantime vizuale dhe diskutime me pjesëmarrësit, duke mundësuar një proces interaktiv konsultimi dhe transparence mbi planifikimet buxhetore dhe investuese të Bashkisë.

1. Programi “Investimet në Infrastrukturën Rrugore dhe Transportin Publik”

Ky program përfaqëson një nga prioritetet kryesore të Bashkisë Durrës në kuadër të Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, duke synuar përmirësimin e infrastrukturës rrugore, lehtësimin e lëvizshmërisë urbane dhe ndërrurbane, si dhe rritjen e sigurisë dhe cilësisë së transportit publik. Gjatë dëgjesave publike të zhvilluara në njësitë administrative, u prezantuan projektet dhe ndërhyrjet e planifikuara për rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugëve, sistemimin e kanaleve kulluese, ndriçimin publik, si dhe investimet për përmirësimin e qarkullimit urban.

Materialet e mëposhtme paraqesin përmbledhjen e **projekteve të propozuara për çdo njësi administrative**, bazuar në nevojat dhe prioritetet e identifikuara gjatë procesit të konsultimit me komunitetin lokal.


Njësia Administrative Ishëm:

TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA PUBLIKE

BASHKIA DURRES



- Rikonstruksion i Njesise Administrative Ishem
- Siperfaqja e gjurmes 353 m²
- 2 kate



INFRASTRUKTURA RRUGORE E PLANIFIKUAR PER VITIN 2025

-Ndertimi infrastruktures rrugore per njesite e banimit ne Ishem


-Rruga Kuraten i vogel, Shkafane – 275 ML



INFRASTRUKTURA RRUGORE E PLANIFIKUAR PER VITIN 2025

-Rruga Fiku i Leres – 660 ML

RIKONSTRUKSION RRUGA FIKU I LERES-NJESIA ADMINISTRATIVE ISHEM
PLANIMETRIA E RRUGES



Njësia Administrative Sukth:

TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA PUBLIKE


QENDRA SHENDETESORE, VADARDHE, SUKTH

Projekti për ndërtimin e “Ndërtimi i qendrës shëndetësore Vadardhe, Njësia Administrative Sukth” është propozuar të zhvillohet në sheshin ku ndodhet Qendra Shendetesore ekzistuese Vadardhe, e cila ka dëmtime të klasifikuara si DS5 dhe ka një Vendim për prishjen e sajë, prej dëmeve të shkaktuara nga termeti i datës 26 Nëntor të vitit 2019.

Vendodhja: 41 °23'47.37"N
19°32'41.54"E

Sipërfaqja e tokës së propozuar për ndërtim është 162 m2.

Sipërfaqja e gjurmës së objektit 1 katësh që propozohet të ndërtohet është 54 m2.



TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA PUBLIKE

BASHKIA DURRES

- Rikonstruksion i Njesise Administrative Sukth



PAMJE NGA JUGU SH 1:100



ZONIMI FUNKSIONAL (KATI PERDHE) SH 1:100





TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA RRUGORE

BASHKIA DURRES

- Rikonstruksion i rruges “Ylli i kuq dhe Fierza”




TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA RRUGORE

BASHKIA DURRES

- Rikonstruktion i rruges "PAQJA"
- Gjatesi 721 ml



PARASHIKIMI PER VITIN 2025 - 2027

SUKTH

- Rruget e fshatit Kulle
- Rruget e fshatit Hamallaj Hidrovor
- Rruga Gjergj Meta Rrushkull
- Rruget ne lagjen 1-6 Vardardhe

Njësia Administrative Manëz:

PER VITIN 2025 E NE VAZHDIM

- Ndertim TREGU USHQIMOR Manez



TE PLANIFIKUARA

1. PROJEKTE NE INFRASTRUKTUREN PUBLIKE


- Rikonstrukcion dhe ndertim i qendrave shendetesore
- Rikonstrukcion dhe ndertim te kopeshteve/çerdheve
- Krijimin e hapsirave publike dhe kende lojërash per femijet
- Permiresim i infrastruktures se varrezave

2. PROJEKTE TE PLANIFIKUARA NE INFRASTRUKTUREN RRUGORE


- Ruga e Borces
- Ruga e Hoxhve
- Ruga Vora
- Ruga Kodrash
- Ruga Ferhatit

Njësia Administrative Katund i Ri:

QENDER STREHIMI DHE TRAJTIMI PER KAFSHET

**KOMPLEKSI SPORTIV – KATUND I RI**

Planimetria e pergjitheshme dhe plani i godines se sherbimeve



RIKONSTRUKSION I NJESISE ADMINISTRATIVE – KATUND I RI



"PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES SE VARREZAVE , NJESIA ADMINISTRATIVE KATUND I RI



Njësia Strukturore: DR_N_N5_463/27
Bashkia Durrës
Njësia DR_N_N5_463/27
Sistemi N Natyror
Kategori 1 N.Tokë Natyrore 100%
Kategori 2
Kategori 3
Kategori 4
Lartësia në Kate 0
Lartësia në Metra 0
PDV JO
Intesitet K1= 0
KSHTK1= 0%
KSHR0%
KSHP 0%
Kufizime Ligjore Sipas neni 34 i Rregullores së PPV-së Durrës
Sipërfaqe (ha) 0.29
Nenkategori 1 N5_Tokë Pa Frut
Nenkategori 2
Nenkategori 3
Nenkategori 4
Parcela Minimale
Përdorime të Lejuara V.I_Varrezë (Brez i rezervuar për varrezë)
Përdorime të Ndaluara
Kushte të Tjera



PLANVENDOSJA E STRUKTURES MBI
AZHORNIMIN E GJENDJES EKZISTUESE SH: 1:2000



TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA RRUGORE

BASHKIA DURRES

- Rikonstruktion "Ura Jube"



PARASHIKIMI PER INFRASTRUKTUREN RRUGORE PER VITIN 2025 - 2027


KATUND I RI

- **Rruga Vau Rrjaes**
- **Rruga Lisakeve**
- **Rruga Levizja e Lire – Domaj**
- **Rruga Vain**

Njësia Administrative Rrashbull:


"RIKONSTRUKSION I NJËSISË ADMINISTRATIVE RASHBULL, DURRËS"

ZONIMI FUNKSIONAL I KATIT PËRDHE



Projekti arkitektonik është gjysmë I gatshëm, cka do të thotë që kemi një planimetri dhe një formë të dhënë të objektit të njësise administrative, e cila do të rinovohet. Në këto kushte ne vlerësojmë se cilët elemente duhen rivlerësuar me qëllim përmirësimin e kushteve dhe të funksionimit të kësaj njësie. Në këtë njësi është bërë një riorganizim I hapësirave të brendshme, duke shtuar dhe hequr mure, me qëllim përshtatjen e këtyre hapësirave në funksion të kërkesave të kësaj njësie.

RIKONSTRUKSION RRUGA "HOXHIEVE" NJESIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, ARAPAJ, DURRES



Rruga rezulton e pashtuara nw pjesen m e te madhe por ka dhe pjese te shtruara ku mungon rrjeti i kanalizimeve t e ujrave te shiut.

Gjerësia e rrugës parashikohen të jenë 4-5 m

Nderhyrja ne kete rruge konsistojnë si më poshtë

- Germim dhe skarifikimi shtresave
- Shtresë cakulli 15 cm sipas projektit
- Shtresë stabilizanti 10 cm
- Shtrese asfalti 4 cm dhe binderi 6 cm.
- Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të shiut me puseta dhe tubacione sipas projektit

RIKONSTRUKSION RRUGA SHALIANTE ,SHENVLASH,RRASHBULL







Rruga rezulton e pashtruar me parë me asfalt. Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujrave të shiut.

Gjerësia e rrugës parashikohen të jenë 45 m


Nderhyrja ne kete rruge konsistojnë si më poshtë

- Germim dhe skarifikimi shtresave
- Shtresë cakulli 15 cm
- Shtresë stabilizanti 10 cm
- Shtrese asfalti 4 cm dhe binderi 6 cm.
- Trotuar anësor tek një pjesë
- Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të shiut me puseta dhe tubacione sipas projektit

SISTEMIM K.U.B NË RRUGËN "EQEREM ÇABEJ",ARAPAJ



PERMIRESIMI I INFRASTRUKTURES SE VARREZAVE, NJESIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL



Aktualisht, varrezat ekzistuese të fshatit Rrashbull janë jashtë kapaciteteve dhe popullsia është në rritje të vazhdueshme.

- Situata në terren është që nuk ka më vende të lira për varrime të reja;
- Mungon një sistem i rregullt parcelimi dhe rrugica të brendshme për aksesim;
- Nuk ekziston infrastrukturë ndihmëse (ndriçim, pika uji, sistem kullimi për ujërat e shiut);
- Hyrja në varreza është e pakontrolluar dhe mungon një rrethim funksional;

Parashikohet realizimi i këtyre ndërhyrjeve:

- Niveli dhe sistemimi i terrenit për ndarjen e re në parcela individuale për varrim;
- Krijimi i rrugicave të brendshme për qarkullim;
- Ndërtimi i rrethimit mbrojtës dhe portës hyrëse;
- Vendosija e ndriçimit dhe sistemit të ujitjes (pika uji);
- Hapësira për shërbime dhe mbjellje pemësh dekorative për mjedis të qetë dhe të përshtatshëm.

Parashikimi për vitin 2025

- Kanal I Kullues (4950 ml)
- Kanal II Kullues (2590 ml)
- Kanal III Kullues (2930 ml)

Total 10.470 ml

Njësia Administrative Nr.4 dhe Nr.6:

RIKONSTRUKSION I NJESISE ADMINISTRATIVE NR.4

Sipërfaqet e ambienteve janë vendosur në planimetri duke patur parasysh të gjitha kërkesat e veçanta të secilës prej tyre. Për të plotësuar normat për sipërfaqet e nevojshme në këtë objekt të shërbimit të qytetarëve , organizimi është bërë duke ruajtur në shumicën e rasteve të njëjtën planimetri,



TE PLANIFIKUARA PER VITIN 2025

INFRASTRUKTURA RRUGORE

BASHKIA DURRES


- Rikonstruksion i rruges "LLOGARA",
SPITALLE



REHABILITIM I KANALIT TE UJERAVE TE LARTA SPITALLE - PORTO ROMANO

Projekti për mbulimin me beton të kanalit të ujërave të larta në zonën Spitalle-Porto Romano është një investim i nevojshëm për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese të kullimit të ujërave në këtë zonë.

Zona që ky projekt është e nderthurur, fushore dhe kodrinore. Pjesa tek vepra e marrjes është fushore e paster dhe ka kuote absolute rreth 5m. Me pas rritet gradualisht dhe shkon në zone kodrinore në piken më të lartë afro 10m. Zona është mjaft e banuar.



Njësia Administrative Nr.5:

RIKONSTRUKSIONI I RRUGES “ADRIA”

Segmenti i rrugës “Adria” ka një gjatësi prej afro 1.7 km. Rruga është e asfaltuar dhe shtresat rrugore përgjithësisht janë në gjendje të mire, përveç disa zonave të vogla. Në profil tërthor rruga është e gjerë 16- 25 m. Gjatë gjithë gjatësisë rruga ka 2 karrexhata të ndara me trafik ndarës me gjerësi 1m. Në fillim të rrugës në segmentin midis dy rreth rrotullimeve të mbikalimit tek Ura e Dajlanit rruga nuk ka trotuare.



RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES "BAJRAM CURRI"



RIKONSTRUKSION SHESH, MIDIS PALLATEVE, RRUGA "QAFE BOTE", PLAZH, DURRES



RIKONSTRUKSION RRUGA “XHEVDET HAFIZI”, PLAZH, DURRES


- Gjatesi 388 ml



RIKONSTRUKSION RRUGA “PJETER BUDI”




RIKONSTRUKSION RRUGA "PALLATET E NISH CIGARES" , NISHTULLA




Njësia Administrative Nr.1, Nr.2, Nr.3:


RIKONSTRUKSION I NJESISE ADMINISTRATIVE NR.1





GJIMANZI GJERGJ KASTRIOTI DHE SITI ARKEOLOGJIK



RINDERTIMI I BANESAVE INDIVIDUALE NE RRUGEN "DALIP PEZA"



FUSHA SPORTIVE E SHKOLLES BERNARDINA QERAXHI




Ky investim perfshin ndertimin e një kompleksi sportiv në ambient të hapur me elementet :

- Fushë futbollit me përmasa 86 m x 45 m
- Pistë vrapimi rreth fushës
- Gropë rëre për kërcim së gjati
- Zonë për hedhje gjyleje

Qëllimi i projektit është krijimi i një hapësire multifunksionale për aktivitete sportive të lira dhe garuese, në përputhje me normat kombëtare dhe ndërkombëtare , për Shkollën e mesme Sportive“Bernardina Qerraxhia”.

PLANI I DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE, PËR 1 BANESË KOLEKTIVE ME NR.32, RRUGA “TEODOR RUPË”



PLANI I DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE, PËR 1 BANESË KOLEKTIVE ME NR.32, RRUGA “TEODOR RUPI”



RIKONSTRUKSION I RRUGES “KASEM DURRËSI”




Objekti Rruga “Kasem Durrësi” është segmenti që lidh qendren e qytetit me Stadiumin e qytetit si dhe Rrugën “Dëshmorët” me Rrugën “Hysen Myshketa”. Rruga ka një gjatësi 631m. Ky segment rrugor ka gjerësi të shtresës ekzistuese asfaltike prej 8.2 m (në fillim të Rrugës “Dëshmorët”) dhe dy trotuare me gjerësi prej afër 4 m në krahun e majtë dhe afër 6m në krahun e djathtë (segment me gjatësi 200m). Segmenti me pas me gjatësi 160m ka gjerësi të shtresës ekzistuese asfaltike prej afër 8 m dhe dy trotuare me gjerësi prej afër 3 m në krahun e majtë dhe te djathtë. Keto trotuar nuk janë te formatuar me permasa standarte dhe janë te demtuar në shtresat e tyre.

Në të gjithë gjatësinë e këtij segmenti rrugor ka ndërtime të tipologjive të ndryshme në të dy krahët kryesisht pallate banimi, shtëpi banimi, supermarkete, kopshte, dyqane, punishte etj.

RIKONSTRUKSION I RRUGES “ALEKSANDER GOGA”

Rruga “Aleksandër Goga” ndodhet në qytetin e Durrësit dhe është segmenti që lidh Sheshin “Liria” e vazhdon deri në Porto Romano. Segmenti nga Sheshi “Liria” deri te Muzeu i Dëshmorëve është rikonstruktuar. Segmenti që kërkohet të rikonstruktohet sipas detyrës së projektimit, është nga Muzeu i Dëshmorëve deri tek Spitali. Rruga ka një gjatësi rreth 1018 m. Ky segment rrugor ka gjerësi të shtresës asfaltike prej 11.6 m dhe dy trotuare me gjerësi që variojnë 2.6-4.8 m. Ky segment rrugor ka ndërtime të tipologjive të ndryshme në të dy krahët kryesisht pallate banimi, shtëpi banimi, supermarkete, kopshte, dyqane si dhe institucione shtetërore shumë të rëndësishme si: Spitali Rajonal Durrës, Rajoni i Policisë, shkolla “Eftali Koci”, etj.



SISTEMIM K.U.B. NE RRUGEN TAULANTIA, LAGJIA NR. 1



Gjendja ekzistuese

Zona e Lagjes Nr. 1, rruga "Taulantia" në qytetin e Durrësit ka hasur probleme me permbytjet gjatë periudhës së reshjeve të dendura, veçanërisht gjatë stinës së shirave. Këto permbytje kanë shkaktuar dëme në infrastrukturën dhe pasuritë e qytetarëve, si dhe kanë vështirësuar qarkullimin e mjeteve dhe sigurinë e jetës. Kjo ka kërkuar ndërhyrje për ndërtimin e një stacioni pompimi për largimin e ujërave të shiut dhe parandalimin e permbytjeve.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky stacion pompimi do të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme për problemet e permbytjeve në këtë zonë të Durrësit. Me tre pompa të tipit zhytës dhe një kapacitet total prej 200 l/s, stacioni do të mund të përballojë çdo ngarkesë të mundshme gjatë stinëve të shirave.

Punimet për rrjetin e KUB do të kryhen në muajt me intesitet të ulët shiu pasi me ardhjen e shirave vështirohet punimet në terren.

Ndërhyrja do të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur për të parandaluar dëmet e mëtejshme dhe për të siguruar një kullim efikas të ujërave të shiut.

STUDIM, PROJEKTIM I PROJEKTEVE PRIORITARE TE INFRASTRUKTURES PUBLIKE NE BASHKINE DURRES

1. Pallati Nr. 16, rruga “Jahja Ballhysa, lagjja nr. 17, me kod gis 3102, Durres
2. Pallatin Nr. 18 (901), rruga “Kristo Sotiri”, lagjja nr. 18, kod gis, 22378, Durres
3. Pallati nr. 27, rruga “Dalip Peza”, lagjja nr. 17, kod gis 1484/1, Durres
4. Pallati nr. 52, rruga “Hysen Kertusha”, kod gis 23005, Bashkia Durres
5. Pallati nr. 103, rruga “Aleksander Goga”, lagjja nr.9, kod gis 24935, Bashkia Durres
6. Pallati nr. 196, rruga “Pavarsia”, kod gis 5513, Bashkia Durres
7. Pallati “Mustafa Pash Bushati”, rruga “Bajram Tusha”, lagjja nr. 14, kod gis 4911, Bashkia Durres.

2. Programi “Shërbimet Sociale”

Në kuadër të dëgjësive publike të zhvilluara për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, u prezantuan materialet lidhur me Programin “Shërbimet Sociale”. Ky program ka si qëllim forcimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për grupet në nevojë, përmes ofrimit të shërbimeve të integruara dhe të qëndrueshme në nivel vendor.

Gjatë prezantimit u paraqitën objektivat strategjike, projektet në zbatim dhe ato të planifikuara për periudhën në vijim, me fokus tek përmirësimi i infrastrukturës së qendrave sociale, zgjerimi i shërbimeve për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe rritja e ndërveprimit ndërmjet strukturave vendore dhe komunitetit.

Nëpërmjet këtij programi, Bashkia Durrës synon të garantojë përfshirje sociale, mbështetje të vazhdueshme për kategoritë vulnerabël dhe një sistem shërbimesh më efikas, të aksesueshëm dhe të përshtatur me nevojat e qytetarëve.

Materialet e mëposhtme paraqesin përmbledhjen e prezantimit të këtij programi:

SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË E DURRËSIT

Do të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Do të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare.

Do të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë.

Do të ngrihen programe fuqizuese dhe shërbime për personat me AK.

Do të zgjerohen shërbimet komunitare multifunkionale për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Do të fuqizohen shërbimet për të mbijetuarit e DHF dhe DHBGJ.

Do të krijohen shërbime fuqizuese për të rinjtë me aftësi të kufizuara.



FËMIJËT

Ofrimi i shërbimeve të emergjencës për fëmijët në situata rreziku të lartë;

Ngritja e shërbimeve të mbështetjes psiko-emocionale për fëmijët e abuzuar;

Ngritja e shërbimit të Kujdestarisë;

Mirëmenaxhimi i rasteve të fëmijeve në nevojë për mbrojtje



Komunitetin Rom dhe Egjyptian

Zbatimi i programit të mbështetjes pas shkollore për fëmijët e komunitetit në Qendrën Multifunksionale Nish Tulla;

Ofrimi i programeve fuqizuese për familjen.

Ofrimi i programeve ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Rom dhe Egjyptian.



Krijimi i mundësive për përfitimin nga programet e strehimit

PROGRAMET PARANDALUESE

Do të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara

Rritja e ndërgjegjësimit publik për problemet sociale që shqetësojnë komunitetin e Durrësit

Do të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet egzistuese



Qendra Komunitare për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar

Qendra ofron shërbime që synojnë rehabilitimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe komunitet, nëpërmjet ndërhyrjes me trajtime të individualizuara, mbështetjes së familjes dhe ndërgjegjësimit komunitar.

1

Shërbimet:

- I. Shërbime direkte për fëmijët me aftësi të kufizuara (2-21 vjeç) në fushën e sjelljes, komunikimit, autonomisë, aftësive akademike dhe motorikës.
- II. Rritje e kapaciteteve të prindërve dhe familjarëve për të punuar me fëmijët në shtëpi dhe për të advokuar për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim dhe komunitet.
- III. Ndërgjegjësim i komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Totali përfitues:

173 fëmijë dhe familjet e tyre

Aktualisht përfitues:

82 fëmijë dhe familjet e tyre

Financimi:

Bashkia Durrës



Qendra Ditore e të Moshuarve

Qendra ofron shërbime që synojnë të mbështesin moshën e tretë për t'i aftësuar për të jetuar një jetë normale dhe integruar ata në shoqëri.

2

Shërbimet:

- ❑ Mbështetje psiko-sociale (këshillimi në grup dhe individual)
- ❑ Shërbim mjekësor (vizita mjekësore, diskutime mbi tema të ndryshme mbi shëndetin, injeksione/mjekime)
- ❑ Ushqim (caj/kafe dhe dreka)
- ❑ Aktivitet social-kulturor brenda dhe jashtë institucionit (të moshuarit kalojnë një kohë cilësore përmes angazhimit në veprimtari sociale dhe argëtuese)

Numri i përfituesve:

110 të moshuar

Financimi:

100% Bashkia Durrës



Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen

Qendra ka për mision "Mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror si dhe të ofrojë shërbime që synojnë të ndikojnë pozitivisht në jetën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabel", me fokus kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi.

3

Shërbimet:

I. Shërbimi emergjent i mbrojtjes 72+ orë për fëmijët në nevojë për mbrojtje të menjëhershme pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe gra e fëmijë viktime të dhunës në familje të cilëve ju ofrohet:

- ☐ Strehimi
- ☐ Mbulimi i nevojave shëndetësore, mirëqenia e fëmijëve
- ☐ Mbulimi i nevojave ushqimore
- ☐ Manaxhimi i problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve
- ☐ Sigurimi i materialeve të buta
- ☐ Siguria për jetën

II. Shërbime mbështetëse me qëllim zhvillimin komunitar

- ☐ Programe për fuqizimin dhe zhvillimin pozitiv të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve: mbështetje psiko-sociale, trainime, ërkshope
- ☐ Aktivitete komunitare ndërgjegjësuese për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e mirëqenies sociale.

Totali përfitues:

316 fëmijë dhe 98 të rritur

Përfitues 2022:

164 fëmijë dhe 57 të rritur

Financimi:

- ☐ Fondi social (MSHMS) – 30%
- ☐ Bashkia – 30%
- ☐ eord Vision – 40%



Shtëpia e Foshnjës

Është institucion që ka për qëllim ofrimin e shërbimit rezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijë duke siguruar mbrojtje, zhvillim dhe integrim në jetën shoqërore duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

4

Shërbim rezidencial:

- ☐ Shërbimi 24 orë për fëmijët rezidencial të moshave 0-6 vjeç
- ☐ Shërbimi mbështetës i familjes

Shërbimi ditor komunitar:

Përmes qendrës komunitare, SHF u vjennë ndihmë e familjeve me probleme të thella social-ekonomike, duke synuar punësimin e prindërve dhe duke nxitur mirëqenien e familjeve.

Shërbimi ditor për fëmijët 3-6 vjeç nga familjet me vulnerabilitet të zonës ku operon.

Shërbimi ditor:

25 fëmijë

Shërbimi rezidencial:

18 fëmijë

Financimi:

- ☐ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Qendra Komunitare Multifunkionale Nishtulla

Qendra ka për mision për të fuqizuar dhe për të siguruar mirëqenie sociale për komunitetin e Nishtullës përmes ofrimit të asistencës, aktiviteteve dhe shërbime të përkujdesjes transformuese për individët dhe komunitetin.

5

Shërbime:

- ☐ Këshillimi psikologjik individual dhe në grup;
- ☐ Mbështetja psiko-sociale
- ☐ Manaxhimi i rasteve në nevojë;
- ☐ Shërbimi ditor për fëmijë parashkollorë nga familje të marginalizuara;
- ☐ Klasa prindërimi/mbështetjeje dhe aftësim për jetën;
- ☐ Shërbim biblioteke dhe kënd lojërash/argëtimi;
- ☐ Mbështetje për punësim;
- ☐ Realizimi i aktiviteteve të ndryshme informuese, kulturore, argëtuese, krijuese, sportive;

Totali përfitues 2022:
300 persona

Financimi:
Bashkia Durrës



Qendra Komunitare Multifunkionale Rrashbull

Qendra ka në fokus mbështetjen, fuqizimin dhe integrimin social të familjeve, veçanërisht për emigrantët e rikthyer nga emigracioni

6

Shërbime:

- ☐ Aktivitete për gjenerimin e të ardhurave në ngritjen e minibizneseve në fusha të ndryshme si psh parukeri-estetikë, rrobaqepsi, blegtori, tregti etj
- ☐ Program i formimit të paguar në vëndin e punës
- ☐ Këshillim për karrierën
- ☐ Mbështetjen pas shkollëre
- ☐ Klasa prindërimi
- ☐ Këshillime individuale dhe në grup me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit
- ☐ Aktivitete ndërgjegjësuere, kuturore dhe argëtuese me prindërit dhe fëmijët

Totali përfitues:
411 persona

Financimi:
☐ Bashkia Durrës
☐ Terre des Hommes



Qendra e shërbimeve me bazë komunitare Njësia Administrative Sukth


- Projekti: “Shërbimet e integruara sociale për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve vulnerabël” - Faza II, është pjesë përbërëse e Programit LNB.
- Periodja e zbatimit: Janar 2022 – Korrik 2025 (43 muaj), por në vitin 2024 buxhetohet nga Bashkia Durrës. Ai zbatohet nga Fondacioni “Ndhimë për Fëmijët” (NPF) dhe Bashkisë Durrës nën përkrahimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të UNDP-së. Projekti po ndërton modelin e shërbimeve sociale të integruara për familjen, i cili synon fuqizimin e familjeve për të thyer rrethin vicioz të varfërisë. Punonjësit socialë të bashkisë do të angazhohen në ofrimin e shërbimeve duke synuar nevojat e familjes në tërësi dhe duke marrë parasysh dhe adresuar nevojat specifike, komplekse dhe afatgjata të secilit prej anëtarëve të familjes. Bashkitë do të krijojnë modelin e ri të ofrimit të shërbimeve sociale të integruara brenda bashkisë dhe do të forcojnë kapacitetet dhe ekspertizën e tyre për të ofruar, mbështetur dhe zgjeruar këtë model. Mbi 50 familje janë trajtuar me shërbime sipas nevojave specifike që kanë pasur, janë mbështetur me programin e rigjenerimit të të ardhurave 7 raste, 12 të rinjë janë orientuar për punësim dhe kurse formimi profesional.
- Financimi : Bashkia dhe PNUD

11/7/2025

Qendra “Fuqizojmë Komunitetin”

- Është pjesë e projektit “Increasing Community Resilience” (ICR) i zbatuar nga UNDP me mbështetjen e Qeverisë së SHBA/USAID në partneritet me Bashkinë Durrës dhe Qendrën për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” dhe në përpunje me prioritetet e Qeverisë Shqiptare. Qendra ofron shërbime të qëndrueshme, të integruara sociale dhe fuqizuese për komunitetet dhe grupet në nevojë në Bashkinë e Durrës.

8	Manaxhim Rasti	Mbështetje për edukim	Fuqizim ekonomik	Aktivitete psikosociale	Shërbim Lëvizës	Shëndeti mendor
	☐ Vlerësim individual ☐ Plan individual/ndërhyrje ☐ Informacion dhe ndihmë për aksesin në burimet komunitare ☐ Ndërhyrje në rast krizash ☐ Rritje kapacitetsh dhe mentorim i rrjetëve profesionale ☐ Operacionalizimi i NARU (NjVRN)	☐ Kurrikula të përpunuara me zhvillimin e fëmijës ☐ Programe edukimi të dizajnuara sipas nevojës : analfabetizmi, after-school, aftësi jetësore, terapi arti ☐ Shërbime shtesë mbështetëse ☐ Mentorim dhe support për mësuesit ndihmës të fëmijëve me AK	☐ Programe të aftësive të lidershit ☐ Punëtorit dhe trajnime mbi komunikimin, zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e konflikteve ☐ Aktivitetet në grup dhe shërbimi në komunitet ☐ Shërbimet e këshillimit të mbështetjes sipas nevojës ☐ Mbështetje ekonomike për gratë vulnerabël të prekura nga DhF	☐ Program argëtues dhe zhvillues për kampin veror ☐ Një shumëllojshmëri aktivitetesh: sporte, arte dhe vepra artizanale ushtrime për ndërtimin e ekipit ☐ Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive me moshatarët dhe të rriturit	☐ Shërbime këshillimi dhe referimi ☐ Terapi fizike, profesionale dhe e të folurit	☐ Mbështetje psikologjike për personat me aftësi të kufizuara ☐ Terapi fizike, profesionale dhe e të folurit për personat me aftësi të kufizuara ☐ Mbështetje psikologjike për prindërit e fëmijëve/të rinjëve me aftësi të kufizuara ☐ Punëtorit për fuqizimin e të mbijetuarve të dhunës ☐ Fuqizimi i vetë-efikasitetit për të moshuarit



3. Programi “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”

Në kuadër të dëgjesave publike të zhvilluara për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, u prezantuan materialet lidhur me Programin “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”. Ky program ka si objektiv përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, përmes investimeve në infrastrukturë, pajisje mësimore, dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit arsimor.

Gjatë prezantimit u trajtuan projektet në zbatim dhe ato të planifikuara për periudhën në vijim, të cilat synojnë modernizimin e ambienteve shkollore, zgjerimin e rrjetit të institucioneve arsimore dhe sigurimin e kushteve më të mira për zhvillimin e fëmijëve dhe nxënësve. Nëpërmjet këtij programi, Bashkia Durrës synon të garantojë akses të barabartë në arsim cilësor për të gjithë fëmijët, të forcojë lidhjen mes shkollës dhe komunitetit, si dhe të krijojë një mjedis të sigurt dhe nxitës për zhvillimin arsimor dhe social të brezit të ri.

Më poshtë paraqiten materialet që u prezantuan në kuadër të Programit “Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar”, si pjesë e procesit të dëgjesave publike për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026–2028.

Arsimi parauniversitar

Bashkia Durrës ka:

- ▶ **5 çerdhe funksionale ne Durrës (institucione përkujdesje dhe edukimi) me 666 fëmijë dhe 1 çerdhe ne NJA Manëz me 12 fëmijë, total 6 cerdhe me 678 fëmijë.**
- ❖ **55 kopshte me 3415 fëmijë në arsimin parashkollor, nga të cilat:**
- ❖ **13 kopshte me ushqim në Bashkinë Durrës me 1577 fëmijë.**
- ❖ **42 kopshte pa ushqim me 1838 fëmijë (14 kopshte në qytet me 766 fëmijë dhe 28 kopshte shkollash në 5 Njësitë Administrative me 1072 fëmijë)**
- ▶ **Shkolla 9 vjeçare gjithsej 41 me 16524 nxënës**
- ▶ **Shkolla të mesme gjithsej 13+2 me 4046 nxënës**
- ▶ **Shkolla profesionale gjithsej 2 me 1998 nxënës.**
- ▶ **Konvikte të shkollave profesionale gjithsej 2 me një numër prej 68 nxënës.**

OBJEKTIVAT E ARSIMIT

- Drejoria AKRSKF e realizon veprimtarinë e saj nëpërmjet Sektorit të Arsimit dhe Qendrës Ekonomike të Arsimit duke menaxhuar dhe administruar 86 godina arsimore si dhe 491 punonjës që i takojnë sistemit parauniversitar të arsimit, nga këto 233 edukativ dhe 258 punonjës ndihmës.

Në PBA 2026-2028 objektivat e Arsimit janë si me poshtë:

1. Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i shkollave të arsimit të mesëm dhe 9 vjecar, (deri në fund të vitit 2030 të gjitha godinat të kënë përfunduar)
2. Rritja e frekuentimit të nxënësve në konvikte.
3. Rritja e cilësisë së edukimit në institucionet parashkollore dhe ato 9-vjeçare përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm të stafit edukativ dhe përditësimit të mjeteve mësimore.
4. Garantimi i kushteve higjeno-sanitare dhe rritja e sigurisë në godinat e institucioneve arsimore publike.

Plani I Arsimit Parauniversitar

- Është miratuar Plani I Arsimit Parauniversitar me VKB nr. 56, datë 10.09.2025 “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Durrës”, në të cilin paraqiten të detajuara të gjitha informacionet për institucionet arsimore të Bashkisë Durrës si dhe planifikimi i të gjitha investimeve në PBA 2026-2028 të Bashkisë Durrës, të cilat do t’i paraqesim në vijim.

1. Përmirësimi i infrastrukturës

- ▶ Përmirësimi i infrastrukturës në Bashkinë e Durrësit kryhet nëpërmjet dy programeve që nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019:

1-Programit të Rindërtimit

2-Programit të investimeve me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)

Programi i Rindërtimit

Bashkia Durrës ka në proces rindërtimi 38 objekte, nga të cilat 34 kanë përfunduar dhe 4 janë në proces si më poshtë:

- ▶ 34 objekte të përfunduara (25 ndertime të reja/9 rikonstruksione)
- ▶ 4 objekte në proces (3 ndertime të reja/1 rikonstruksion)

Financimet e procesit të rindërtimit të ndara sipas donatorëve

- ❖ 13 objekte FShZh
- ❖ 18 objekte UNDP(EU4Schools) financim BE
- ❖ 1 objekt KFW gjermane financim qeveria gjermane
- ❖ 4 objekte CIS (Community Infrastructure Support) Danimark + Mbretëri e Bashkuar
- ❖ 2 objekte me financim nga të ardhurat e veta të Bashkisë Durrës

1- Programi i Rindërtimit

Ndertime të reja në proces

1. Shkolla Mesme Bashkuar "Rexhep Mezinë", NJA Ishëm/ KfV gjermane/ përfundon në Tetor 2025
2. Shkolla e Mesme Manëz/financim Bashkia Durrës/përfundon në Janar 2026.
3. Shkolla 9 vjeçare "Vadardhë", NJA Sukth /financim B. Dr/përfundon në Maj 2026
4. Shkolla 9 vjeçare "Met Hasa"/financim B.Dr/Përfundon mars 2026

Rikonstruksion në proces

1. Shkolla 9 vjeçare " Kushtrimi i Lirisë ", Durrës/Me Vendim KSHR-je kaluar në programin e rindërtimit me programin EU4Schools, zbatuar nga UNDP/pritet të përfundojë në Nëntor 2025

Objekte të përfunduara brenda vitit 2025, nga programi i rindërtimit

❖ Në vitin 2025 kanë përfunduar këto objekte arsimore:

1. Shkolla Mesme Sportive "Benardina Qerraxhi", Durrës/Korrik 2025
2. Konvikti i shkollës "Bernardina Qeraxhi", Durrës /Korrik 2025
3. Konvikti i vjetër i shkollës "Beqir Çela", Durrës/Janar 2025
4. Shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë dhe Kopësht/Janar 2025

2-Programi i dytë: Investime me fondet e veta të NJQV (Bashkisë Durrës)

VITI 2025-2028

- ▶ Ndërtim shkolle e re nga bashkimi i 2 shkollave 9 vjeçare: "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza"/Janar 2027
- ▶ Rikonstruktion total shkolla 9 vjeçare "Bajram Curri"/Tetor 2025
- ▶ Ndërtim i ri shkolla 9 vj "Bishtkamëz"/Shkurt 2026-Gusht 2026
- ▶ Ndërtim shkolla e mesme «Gjergj Kastrioti"/2028
- ▶ Rikonstruktion shkolla "Dom Nikoll Kaçorri"/2025

Objekte të përfunduara brenda vitit 2025, nga programi me fonde të Bashkisë Durrës

VITI 2025

- ▶ Rikonstruktion shkolla 9 vjeçare "Demokracia"/përfunduar ne Janar 2025
- ▶ Ndërtim i terreneve të mbyllura sportive në shkollat 9 vjeçare "Jusuf Puka" dhe "Abedin Dino" /përfunduar në korrik 2025

Objekte arsimore NJA Ishem

- ▶ MB “Rexhep Mezin” (Ndërtim I ri KfV gjermane Ishëm/Përfundon në Tetor 2025)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Pren Simoni”, Draç (Rikonstruksion dhe rrethim me fonde B.D. përfunduar në Shtator 2023, aktualisht 12 fëmijë)
- ❖ Kopshti Bizë “Filizat e Vegjel” ndërtim i ri/UNDP (përfunduar, filluar nga puna në dhjetor 2023 /aktualisht ka 6 fëmijë.)
- ❖ Kopshti Fushë Draç/(Eshtë marrë ambjent me qera, në kopsht present 8 fëmijë)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Xhelal Shtufi” Shkafanaj + kopshti (3 grupe) (Ndërtim I ri//dhjetor 2020, FSHZH)
- ▶ Shkolla “Vat Bushi”, Lalëz (Rikonstruksion total nga bashkëfinancimi; Bashkia Durrës, FSHZH, KfV). Ky objekt shfrytëzohet si qendër komunitare për të rinjtë dhe të moshuarit e qendrës administrative Ishëm).

Objekte arsimore NJA Manëz

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Riza Shera”+ kopsht, Radë (Rikonstruksion dhe shtesë, financim me fondet e BE zbatuar UNDP me programin EU4Schools, ka përfunduar në Janar 2025). Fëmijët që kanë frekuentuar kopshtin në Kameras janë zhvendosur në ambjentet e kësaj shkolle, aktualisht frekuentojnë kopshtin 23 fëmijë
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Armath” (Rikonstruksion, bashkëfinancim Bashkia Durrës me FSHZH/ përfunduar në vitin 2019), 12 fëmijë
Kopshti Hamallaj/12 fëmijë dhe Kopshti Shkallë/10 fëmijë
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Zyber Sallaku”, Kuçok (Rikonstruksion program CIS/përfunduar dhe inaguruar Qershor 2024)
- ▶ Kopshti I ri me ushqim “Reze Drite” pranë shkollës 9 vjeçare “Zyber Sallaku” me tre grupe (ndërtim I ri me programin EU4 schools përfunduar Qershor 2024). Aktualisht frekuentojnë këtë kopsht 71 fëmijë, 21 prej tyre janë me drekë.
- ▶ Gjimnazi Manëz (Ndërtim I ri, financim me fondet e Bashkisë Durrës, pritet të përfundojë në Janar 2026).
- ▶ Rindërtim cerdhja “Lulet e Pranverës” (me fondet e FSHZH / përfunduar, aktualisht janë 12 fëmijë në cerdhe)

Objekte arsimore Nja Sukth

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Njazi Mastori”+ kopesht (Ndërtim I Ri me FSHZH/përfunduar 2021). Frekuentojne kopshtin 110 femije,nga te cilet 31 femije jane me dreke.
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Vadardhë”/fonde B.Dr./pritet te perfundoje ne Maj 2026). Frekuentojne kopshtin 83 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Hamallaj”,(Ndërtim i ri me fondet e Bashkisë Durrës/përfunduar 2020 (oborr+rrethim rregullim 2023). Frekuentojne kopshtin 49 femije+34 femije ne Perlat
- ▶ Shkolla 9 vjeçare”Pal Zefi “Rrushkull. (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durrës) Frekuentojne kopshtin 45 femije.
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “CU Perlat” (Ndërtim I ri me FSHZH shkollë fillore dhe kopësht/përfunduar 2021)
- ▶ Shkolla MB “Ismet Nanushi” Kullë + Kopesht godine e vecante (Ndërtim I ri EU4Schools/përfunduar 2022). Frekuentojne kopshtin 100 femije
- ▶ Shkolla e mesme “Dhosi Liperi” (Ndërtim i ri/përfunduar në mars 2023)

Objekte arsimore NJA Katund i Ri

- ▶ MB Jusuf Hoti/Kat.RI (Rikonstrukcion shkolla egzistuese dhe ndërtim i ri shkollë fillore dhe kopësht, programi CIS,bashkëfinancues me Bashkinë Durrës/inaguruar shtator 2024). Frekuentojne kopshtin 24 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Artan Zeka”,Qerret(Ndërtim i ri/financuar Bashkia Durrës/Përfunduar 2020), aktualisht 35 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bisht Kamez” (Ndertim I ri me fondet e B.Dr, pritet te fillojne punimet ne Shkurt 2026), 20 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bajram Gashi”, Fllakë (Rrethim + lyerje 2023-2024), 30 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Sukth Katund” (Sistem ngrohje, rrethim, kalçeto/Fondet e Bashkisë Durrës/2019), 34 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Fshat Rinia” (Ndërtim I Ri/Fondet e Bashkisë Durrës/Përf.vitin 2020)+rikonstrukcion fushe sporti e mbuluar bashkefinancim me World Vision/shtator 2023), 46 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Jubë” (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durrës per t’u perfshire ne buxhetin e ardhshem te B.Dr), 24 femije ne kopesht

Objekte arsimore NJA Katund i Ri

- ▶ MB Jusuf Hoti/Kat.RI (Rikonstrukcion shkolla egzistuese dhe ndërtim i ri shkollë fillore dhe kopësht, programi CIS,bashkëfinancues me Bashkinë Durrës/inaguruar shtator 2024). Frekuentojne kopshtin 24 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Artan Zeka”,Qerret(Ndërtim i ri/financuar Bashkia Durrës/Përfunduar 2020), aktualisht 35 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bisht Kamez” (Ndertim I ri me fondet e B.Dr, pritet te fillojne punimet ne Shkurt 2026), 20 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bajram Gashi”, Fllakë (Rrethim + lyerje 2023-2024), 30 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Sukth Katund” (Sistem ngrohje, rrethim, kalçeto/Fondet e Bashkisë Durrës/2019), 34 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Fshat Rinia” (Ndërtim I Ri/Fondet e Bashkisë Durrës/Përf.vitin 2020)+rikonstrukcion fushe sporti e mbuluar bashkefinancim me World Vision/shtator 2023), 46 femije ne kopesht
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Jubë” (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durrës per t’u perfshire ne buxhetin e ardhshem te B.Dr), 24 femije ne kopesht

Objekte arsimore Nj.A. Rrashbull

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Vëllezërit Haradinaj”, Rrashbull (Ndërtim I ri/program I rindërtimit dhjetor 2020/FSHZH), frekuentojne kopshtin 58 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Myslym Hidaj”, Arapaj (Ndërtim i ri me fondet e Bashkisë Durrës/përfunduar në vitin 2018+lyerje, izolim dritare, eliminim lageshtie nga palestra,lyerje kopshti/shtator 2024), frekuentojne kopshtin 41 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Shefqet Ndroqi”, Romanat (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durrës, per t’u perfshire ne buxhetin e ardhshem te B.Dr) frekuentojne kopshtin 28 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Hamza Muca”, Shkallnur (Pritet vleresimi dhe planifikimi nga grupet teknike te Bashkise Durrës per t’u perfshire ne buxhetin e ardhshem te B.Dr) frekuentojne kopshtin 30 femije
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bilal Golemi” (Stacioni Zooteknik Xhafzotaj) (ndertim viti 2013 me fondet e bashkise /Sistemi I ngrohjes/2020), frekuentojne kopshtin 80 femije
- ▶ MB “Besnik Hidri” Shënvllash (Rikonstrukcion total me fondet e Bashkisë Durrës/perfunduar janar 2024), frekuentojne kopshtin 26 femije

Objekte arsimore Durres

- ▶ Bedrie Bebeziqi (Ndërtim I ri FSHZH/2021)
- ▶ Jusuf Puka (Rikonstruksion me fondet e BD/2020, Ndërtim I terrenit të mbyllur sportiv /korrik 2025)
- ▶ Shaqe Mazreku (Ndërtim I ri FSHZH/2020)
- ▶ Nënë Tereza+Vasil Ziu (shkollë e re me fondet e BD/2027)
- ▶ Marie Kaçulini (Ndërtim i ri me fondet e BD/2018)
- ▶ Kushtrimi Lirisë (Rikonstruksion UNDP/Eu4Schools, pritët të perfundojë në Nëntor 2025)
- ▶ 14 Nëntori (Rikonstruksion + palester e re EU4Schools/perfunduar shtator 2024)
- ▶ Qemal Mici (Ndërtim I ri FSHZH/2021)
- ▶ Hajdar Dushi (Rikonstruksion me fondet e BD/2020)
- ▶ Eftali Koçi (Ndërtim I ri EU4Schools/mars 2024)
- ▶ Hasan Koçi (Ndërtim I ri FSHZH/2020)

Objekte arsimore Durres

- ▶ Neim Babameto (Ndërtim i ri FSHZH/2020)
- ▶ Met Hasa (Ndërtim i ri me fondet e BD/Perfundon Mars 2026)
- ▶ Bajram Curri (Rikonstruksion me fondet e B.Dr/fillon në Tetor 2025)
- ▶ Abedin Dino (Ndërtim I ri me fondet e BD/2016 + Ndërtim I terrenit të mbyllur sportiv/korrik 2025)
- ▶ Demokracia (Rikonstruksion me fondet e B.Dr/perfunduar në Janar 2025)
- ▶ Isuf Ferra (Rikonstruksion me fondet e BD/2018. Palestra e shkolles 9 vjeçare “Isuf Ferra” perfunduar shtator 2024 me prog.CIS zbatuar UNDP)
- ▶ PLM (Rikonstruksion me fondet e BD/2018)
- ▶ E Re Kënetë bashkëfinancim me W.Vision riparim sistem ngrohje dhe sistem elektrik 2020
- ▶ MB Jan Kukuzeli (Rikonstruksion 30% bashkefinancim me FSHZH/2019)
- ▶ Shkolla e mesme sportive “Bernardina Qeraxhi” + konvikti (Ndërtim I ri UNDP/perfunduar Korrik 2025, në proces ndërtimi i sistemit të drenazhit të fushës së sportit të shkollës me fonde të B.Durres)
- ▶ Shkolla e mesme Dom Nikoll Kacorri (Rikonstruksion total me fonde të BD/fillon në 2025)
- ▶ Shkolla e mesme Gjergj Kastrioti (Ndërtim I ri me fondet e BD/2028)

Objekte arsimore Durres

- ▶ Shkolla e mesme Leonik Tomeo (Rikonstruksion BD/2019)
- ▶ Shkolla e mesme Naim Frashëri (Ndërtim i ri EU4Schools/perfunduar gusht 2024)
- ▶ Shkolla e mesme Olsi Lasko (Ndërtim I ri EU4Schools /përfunduar në korrik 2023)
- ▶ Konvikti I shkollës së mesme profesionale “Beqir Cela” (Ndërtim I ri UNDP/perfunduar janar 2025 ne proces ndertimi I kabines elektrike me fonde te B.Durres)
- ▶ Shkolla e mesme Teknologjike “Hysen Cela” (Rikonstruksion me EU4Schools/ përfunduar 2021)

Objekte arsimore rajoni 3 dhe lagja 18

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Marie Kaçulini” (Ndërtim i ri me fondet e BD/2018)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Kushtrimi Lirisë” (Rikonstruksion UNDP/Eu4Schools, pritet te perfundoje ne Nentor 2025)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “14 Nëntori” (Rikonstruksion + ndertim palestere EU4Schools/inaguruar shtator 2024)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Qemal Mici” (Ndërtim I ri FSHZH/2021)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Eftali Koçi” (Ndërtim I ri EU4Schools/mars 2024)
- ▶ Shkolla e mesme sportive “Bernardina Qeraxhi” + konvikti (Ndërtim I / Programi EU4Schools/perfunduar Korrik 2025 /ne proces ndërtimi i sistemit të drenazhit të fushës së sportit të shkollës me fonde te B.Durres)
- ▶ Shkolla e mesme “Leonik Tomeo” (Rikonstruksion BD/2019)
- ▶ Shkolla e mesme “Naim Frashëri” (Ndërtim i ri EU4Schools/perfunduar shtator 2024, ndertim kabine elektrike dhe pajisje perfunduar me fonde te B.Durres)
- ▶ Shkolla e mesme Teknologjike “Hysen Cela” (Rikonstruksion me EU4Schools/ përfunduar 2021)

Objekte arsimore rajoni 4 dhe Rajoni 6

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Demokracia” (Rikonstruksion me fondet e B.Dr/perfunduar ne Janar 2025)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Neim Babameto” Ndërtim I ri FSHZH 2020
- ▶ Kopshti shkolles 9 vjeçare “Neim Babameto”/Rikonstruktuar me fondet e B.Durres/kthyer ne kopesht me ushqim 2024
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Met Hasa” (Ndërtim i ri me fondet e BD/Perfundon Mars 2026)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare e Re, Kënetë/(sistem ngrohje dhe sistem elektrik bashkefinancim World Vision 2020), bashkëfinancim World Vision-Bashkia Durrës, ndertim terren multidisiplinar të mbuluar /përfunduar shtator 2024)
- ▶ Shkolla e mesme Dom Nikoll Kacorri (Rikonstruksion total me fonde te BD/fillon ne 2025)

Objekte arsimore Plazh/Shkozet

- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Abedin Dino” (Ndërtim I ri me fondet e BD/2016, Ndertim I terrenit te mbyllur sportiv/korrik 2025)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Bajram Curri” (Rikonstruksion me fondet e B.Dr/fillon Tetor 2025)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Isuf Ferra” (Rikonstruksion me fondet e BD/2018) Palestra e shkolles 9 vjeçare “Isuf Ferra” perfunduar shtator 2024 me prog.CIS zbatuar UNDP
- ▶ Kopshti “Isuf Ferra”, Durrës/perfunduar 2024 dhe ka filluar funksionimin si kopesht me ushqim.
- ▶ Shkolla e mesme “Olsi Lasko” (Ndërtim I ri EU4Schools zbatuar UNDP /përfunduar në korrik 2023)
- ▶ Shkolla 9 vjeçare “Hasan Koçi” (Ndërtim I ri FSHZH/2020)
- ▶ Konvikti I shkollës së mesme profesionale “Beqir Cela” (Ndërtim I ri UNDP/perfunduar korrik 2025 ne proces ndertimi I kabines elektrike me fonde te B.Durres)

Objekte te perfunduara //Rindertimi

- ❖ Shkolla 9 vjeçare "Eftali Koci", Durrës /Ndertim I Ri, me programin EU4 schools. mars 2024
- ❖ Shkolla 9 vjeçare "14 Nëntori", Durrës /Rikonstruksion+palester e re, me programin EU4 schools, shtator 2024
- ❖ Gjimnazi "Naim Frashëri",Durrës /Ndertim I ri, me programin EU4 schools, shtator 2024
- ❖ Kopshti i shkolles 9 vjecare "Isuf Ferra", Nishtulla Durrës, me programin CIS/ shtator 2024
- ❖ Palestra shkollës 9 vjeçare "Isuf Ferra", Nishtulla Durrës, me programin CIS/ shtator 2024
- ❖ Shkolla 9 vjeçare "Zyber Sallaku", Kuçok (Rikonstruksion me programin CIS/qershor 2024)
- ❖ Kopshti I ri me ushqim "Reze Drite" prane shkolles 9 vjeçare "Zyber Sallaku" me tre grupe(ndertim I ri me programin EU4 schools perfunduar Shtator 2024)
- ❖ Shkolla e Mesme e Bashkuar "Jusuf Hoti"+ kopësht dhe shkollë fillore / shtator 2024

1. Shkolla Mesme Sportive "Benardina Qerraxhi "Durrës, me programin EU4 schools, zbatuar nga UNDP/Korrik 2025
2. Konvikti I shkollës "Bernardina Qeraxhi", Durrës / me programin EU4 schools, zbatuar nga UNDP/Korrik 2025
3. Konvikti I vjetër I shkollës "Beqir Çela", Durrës/me programin EU4 schools, zbatuar nga UNDP/Janar 2025
4. Shkolla 9 vjeçare "Riza Shera" Radë dhe Kopësht/me programin EU4 schools, zbatuar nga UNDP/Janar 2025

4. Paketa Fiskale 2026

Në kuadër të procesit të dëgjësive publike për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2026–2028, u prezantua gjithashtu Paketa Fiskale për vitin 2026, e cila përbën një nga instrumentet kryesore të politikës fiskale të Bashkisë Durrës.

Kjo paketë synon sigurimin e një sistemi të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm të taksave dhe tarifave vendore, në funksion të rritjes së të ardhurave vendore dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Gjatë prezantimit u paraqitën ndryshimet e propozuara në krahasim me vitin fiskal paraardhës, analizat mbi ndikimin e tyre financiar dhe social, si dhe rekomandimet e ardhura nga komuniteti dhe grupet e interesit.

Nëpërmjet kësaj pakete, Bashkia Durrës synon të ruajë balancën midis kapacitetit pagues të qytetarëve dhe nevojës për financim të shërbimeve publike, duke kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të territorit.

Më poshtë paraqiten materialet që u prezantuan në kuadër të diskutimit mbi Paketën Fiskale 2026.

PËR VITIN 2025 NË BASHKINË DURRËS NDRYSHON:

NIVELI I TARIFËS PËR BIZNESET

a) Biznes me qarkullim mbi 10 mln lekë (BM)

b) Biznes me qarkullim nën 10 mln lekë (BV)

TAKSA E NDËRTESES

Çmimi mesatar i referencës

Ishte 67.500 Lekë/ m²

Bëhet 71.157 Lekë/ m²

Sipas Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për zbatimin e çmimeve të reja të referencës për llogaritjen e taksës së ndërtesës”

KETO DO TË REFLEKTOHEN NË PAKETËN

FISKALE TË VITIT 2026

TAKSA E NDËRTESES PËR QËLLIM BANIMI

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat	
			Bashkia Durrës, Shkëmbi Kavajës, Gjiri i Lalëzit	Nj.A. Ishëm, Katundi i Ri, Manëz, Sukth, Rrashbull
1	Ndërtesa Banimi	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	35.58 lekë x m ²	23.1 lekë x m ²
2	Ndërtesat e privatizuara (për banim)	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	24.9 lekë x m ²	

NENI 22 TAKSA MBI NDËRTESAT

6. PËRJASHTOHEN NGA TAKSA MBI NDËRTESAT:

ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;

f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike .

KLASIFIKIMI SIPAS KATEGORISË SË TOKËS BUJQËSORE

KATEGORIA E TOKËS	VLERA E TAKSËS NË LEKË PËR HEKTARË NË VIT (lekë/ha/vit)			
	KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII - X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë

TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Kateg.	Bashkia DR Lekë/ha/vit	Nj.A. Sukth Lekë/ha/vit	Nj.A. Ishëm Lekë/ha/vit	Nj. Adm. Rrashbull Lekë/ha/vit	Nj. Adm. Katund Ri Lekë/ha/vit	Nj. Adm. Manëz Lekë/ha/vit
I	5. 600	3. 920	-----	-----	-----	5. 600
II	4. 900	3. 430	-----	5. 000 (Stac. Zoot. Xhafzotaj)	-----	4. 900
III	4.200	2. 940	2. 940 (Laëz, Bizë, Draç, Kuratën, pjesa e fshatit Kërtushaj- Rrotull)	5. 000 (Fsht. Shenvlash)	2. 940	4. 200
IV	3. 600	2. 520	-----	3.600 (Fsht. Rrashbull)	-----	3. 600
V	3. 000	2. 100	-----	-----	2. 100	3. 000
VI	2. 400	1. 680	1. 680 (Fsht. Gjericaj, Kapidanaj, Likmetaj, Kërtushaj, Shetaj)	2. 520 - (Fsht. Rromanat, Bozanhije)2. 210– (Fsht. Manskuri)2. 600 – (Fsht. Shkallnur, Arapaj)	-----	2. 400
VII - X	1.800	1. 260	1. 260 (Për tokë skeletike pyjore)	-----	-----	1. 800

TARIFAT PËR FAMILJET (LEKË/VIT)

	ZONA-A	ZONA-B
TARIFA		
T. GJELBËRIMI	1,000	500
T. PASTRIMI	3,500	1,500
T. NDRIÇIMI	1,500	1,000
TOTALI	6,000	3,000

TOTALI (ZONA-A)

6000

LEKË/VIT/FAMILJE (VITI 2025)

TOTALI (ZONA-B)

3000

LEKË/VIT/FAMILJE (VITI 2025)

GJENDJA EKZISTUESE:

NSHK Durrës: rajonin 1,2,3,4,5, në Durrës, Sukth, Manëz, Katundi i Ri, Ishëm. **NSHK Plazh:** Igj: 13, 14 në Shkozet dhe Nj.A. Rrashbull.

Viti	Fondi për menaxhimin e mbetjeve aktual (All)	Investimet infrastrukturale (All)	Fondi për menaxhimin e mbetjeve (€)	Kosto totale për ton mbetje sipas VKM 319/2020 (€)	Investimet në euro (€)
2021	417,847,000	695,606,180	3,429,192	34.7	5,708,709

- Totali i mjeteve= 33
- Totali i kontenitorëve= 1647 copë
- Totali i punonjësve= 438 punonjës
- Kosto totale operative (pagat+sig+shpz. operative)= 412,847,000L

QEVERIA SHQIPTARE:

Bashkia Durrës ka lidhur kontratën me Nr. 9853/8 prot. Date 08.10.2021 me operator Integrated Energy BV SPV shpk, Lendfilli në Sharre, ku mbështetja financiare nga Qeveria Shqiptare do të jetë:

Viti I: 114, 886, 400 L

Viti II: 310, 193, 280 L

PARASHIKIMET:

- Rritja me 30% e fondit për menaxhimin e mbetjeve, përkatësisht: 543,201,100L
- Evadimi i mbetjeve urbane: 2 heë në ditë
- Shtim të nr të mjeteve, pasi gjendja ekzistuese e mjeteve është jashtë standarteve të kërkuara
- Shtim të nr të kontenierëve për të mbuluar të gjithë zonën me shërbim

TARIFA E PASTRIMIT:

Zona A përfshin: Qytetin Durrës.

Zona B përfshin: Njesia Sukth, Rrashbull, Manëz, Ishëm, Katund i Ri

Tarifa	Zona A	Zona B
Tarifae Pastrimit	2300	500

FAKT:

50% arrin grumbullimi i tarifës së pastrimit, shifër, e cila nuk arrin të mbulojë as një pjesë të konsiderueshme të fondit për menaxhimin e mbetjeve. = Bashkia Lushnje

TARIFA E PASTRIMIT

Nr	Kategoritë	Nr. I familjeve	NjësiaLekë/vit/familje		
I	FAMILJET		Zona A Qyteti Durrës	Zona B Njesia Sukth, Fshati Perimore Nj A Rrashbull, Fshati Rrashbull, St Zoteknisë dhe Shkallnuri Nj.A.Manez Fsh manez qender Nj A Ishëm,Ishëm qender ,Nj A K Ri. K.Ri	Te gjitha fshatrat e njesive organizative duke perjashtuar fshatrat e cilesuara ne zonen B
1	NjA Durrës	62474	3,500		
2	NjA te Tjera			1,500	0
2.1	NjA Sukth	2786		1,500	0
2.2	NjA Ishëm	1657		1,500	0
2.3	NjA Katundi i Ri	4592		1,500	0
2.4	NjA Rrashbull	7327		1,500	0
2.5	NjA Manëz	2520		1,500	0

Të gjitha zonat rezidenciale kanë të njejtat tarifa si Nj.A. Durrës (Gjiri i Lalzit, Shkëmbi i Kavajës); Përfshihen nga ndryshimet e tarifave kategoritë që kanë qenë përfituese dhe më parë (pensionistë të vetëm, paraplegjikë, tetraplegjikë, dhe që jetojnë me përkrahje sociale)

TARIFA E GJELBËRIMIT

Nr	Kategoritë	Nr. I familjeve	NjësiaLekë/vit/familje	NjësiaLekë/vit/familje	
I	FAMILJET		Zona A Qyteti Durrës	Zona B Njesia Sukth, Fshati Perimore. Nj.A.Rrashbull , Fshati Rrashbull,Shkallnu r, Xhafzotaj Nj.A.Manez Fsh. Manez, Qender Nj A Ishem,Ishem Qender ,Nj A Katund i Ri	Te gjitha fshatrat e njesive organizativ e duke perjashtuar fshatrat e cilesuara ne zonen B
1	NjA Durres	62474	1000		
2	NjA te Tjera			500	0
2.1	NjA Sukth	2786		500	0
2.2	NjA Ishëm	1657		500	0
2.3	NjA Katundi i Ri	4592		500	0
2.4	NjA Rrashbull	7327		500	0
2.5	NjA Manëz	2520		500	0

Të gjitha zonat rezidenciale kanë të njejtat tarifa si Nj.A. Durrës (Gjiri i Lalzit, Shkëmbi i Kavajës); Përfshihen nga ndryshimet e tarifave kategoritë që kanë qenë përfituese dhe më parë (pensionistë të vetëm, paraplegjikë, tetraplegjikë, dhe që jetojnë me përkrahje sociale)

TARIFA E NDRIÇIMIT

Nr	Kategoritë	Nr. I familjeve	NjësiaLekë/vit/familje	NjësiaLekë/vit/familje	
I	FAMILJET		Zona A Qyteti Durrës	Zona B Njesia Sukth, Fshati Perimore. Nj.A.Rrashbull , Fshati Rrashbull,Shkallnur, XhafzotajNj.A.Manez Fsh. Manez, Qender Nj A Ishem,Ishem Qender ,Nj A Katund i Ri	Te gjitha fshatrat e njesive organizative duke perjashtuar fshatrat e cilesuara ne zonen B
1	NjA Durres	62474	1500		
2	NjA te Tjera				
2.1	NjA Sukth	2786		1000	0
2.2	NjA Ishëm	1657		1000	0
2.3	NjA Katundi i Ri	4592		1000	0
2.4	NjA Rrashbull	7327		1000	0
2.5	NjA Manëz	2520		1000	0

Të gjitha zonat rezidenciale kanë të njejtat tarifa si Nj.A. Durrës (Gjiri i Lalzit, Shkëmbi i Kavajës); Përfshihen nga ndryshimet e tarifave kategoritë që kanë qenë përfituese dhe më parë (pensionistë të vetëm, paraplegjikë, tetraplegjikë, dhe që jetojnë me përkrahje sociale)

Shënim:

Për vitin 2026 Ministria e Financave, pas çmimeve të reja të references, po përgatit një projektligj, ku Bashkinë Durrës e ndan në 13 zona kadastrale.

Çdo zonë kadastrale do të ketë çmimin e saj mesatar të references.

Kategoritë që përfitojnë lehtësim nga taksat e popullatës

Me status "Paraplegjik" dhe "Tetraplegjik" janë 50 personatë cilët përjashtohen totalisht nga të gjitha zërat e taksës së popullatës

50 persona x 1500 lekë/vit për sejcilin = 75 000 leke , efekti ekonomik negativ për këtë kategori për Bashkinë

Me status "Individ me ndihmë ekonomike" janë 42 personatë cilët përjashtohen totalisht nga të gjitha zërat e taksës së popullatës

42 persona x 4500 lekë për sejcilin = 189 000 lekë , efekti ekonomik negativ për këtë kategori për Bashkinë

Me status "Pensionist" dhe "Invalid" janë 7850 personatë cilët përjashtohen nga taksa e pasurisë mbi ndërtesën dhe nga tarifa e pastrimit, duke u ngarkuar vetëm me dy tarifat gjelbërim për 1000 lekë në vit dhe ndriçim 1500 lekë në vit, që në total kap shifrën prej 2500 lekë në vit.

7850 persona x 4500 lekë/vit = 35325000 lekë

7850 persona x 2500 lekë/vit = 19625000 lekë

Diferenca 35325000 – 19625000 = 15700000 lekë , efekti ekonomik negativ për këtë kategori për Bashkinë

Në total efekti ekonomik negativ për të gjitha kategoritë për Bashkinë është

67500 + 144000 + 15700000 = 15911500 lekë.

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat	
			Bashkia Durrës, Shkëmbi Kavajës, Gjiri i Lalëzit,	Nj.A. Ishëm, Katundi Ri, Manëz, Sukth, Rrashbull
1.a	Veprimtari tregti dhe shërbime me qarkullim mbi 10 mln lekë	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 213.47 \times m^2$	$71,157 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 213.47 \times m^2$
1.b	Veprimtari tregti dhe shërbime me qarkullim deri nën 10 mln lekë	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 1.5 \times 0.2 \% \times m^2 = 213.47 \times m^2$	$71,157 \times 1.5 \times 0.2 \% \times 35\% = 138.75 \times m^2$
2	Parkim i mbuluar dhe bodrume	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 0.2 \% \times m^2 \times 70 \% = 99.6 \times m^2$	
3	Parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, porte dhe aeroporte të çdo kategorie.	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 42.7 \times m^2$	
4	Veprimtari industriale, arsimore jopublike, pishinat e mbyllura	Lekë/m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 0.2 \% \times m^2 \times 50 \% = 71.15 \times m^2$	
5	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori	Lekë/ m ² /sipërfaqe shfrytëzimi	$71,157 \times 0.2 \% \times m^2 \times 30 \% = 42.7 \times m^2$	

TARIFA E PASTRIMIT (Biznes me qarkullim mbi 10 mln lekë)

TIPI AKTIVITETIT (LEKË/VIT)	ZONA-A & ZONA-B
Bulmet, Mish, Peshk	40,000
Fruta, Perime, Ushqimore	30,000
Pub, Diskoteka	20,000
Bar, Restorant, Fast Food, Kafe internet, Etj të ngjashme me to	50,000
Tregti Karburanti	60,000
Shoqata, Fondazione, Ente, OJQ	5,000
Institucione Administrative Publike	10,000
Organizata Jofitimprurëse	5,000
Zënie Tregti Peshku	30,000

TARIFA E PASTRIMIT (Biznes me qarkullim mbi 10 mln lekë)

TIPI AKTIVITETIT (LEKË/VIT)	ZONA-A & ZONA-B
Për çdo leje ndërtimi, rikonstruksione të objektit ekzistues, shtesë 1 kate mbi ekzistues, shtesë 1 kate mbi ekzistuesen ku objekti bëhet deri në 2 kate, ndryshime funksioni përdorimi, si dhe për objekte 1-2 kate mbi tokë	40,000
Për çdo leje ndërtimi për objekte 3-4 kate mbi tokë	80,000
Për çdo leje ndërtimi për Objekte industriale dhe turistike si dhe objekte shërbimi e banimi memë shumë se 4 kate mbi tokë	150,000
Subjekte ndërtuese për selinë administrative	50,000

TARIFA E PASTRIMIT (Biznes me qarkullim mbi 10 mln lekë)

TIPI AKTIVITETIT (LEKË/VIT)	ZONA-A & ZONA-B
Hotele, Motele, Komplekse Turistike, Pensione	60,000 lekë+ 1,000 lekë/dhomë/vit
Shtëpi Pushimi Private	40,000 + 2,000 lekë/dhomë/vit
Shtëpi Pushimi Shtetërore	15,000 + 500 lekë/dhomë/vit
Aktivitete Sportive, Ekspozita dhe Panaire	50,000
Transport Mallrash	20,000

TARIFA E PASTRIMIT (BIZNESI I VOGËL)

TIPI AKTIVITETIT (LEKË/VIT)	ZONA-A	ZONA-B
Bulmet, Mish, Peshk	20,000	20,000
Fruta, Perime, Ushqimore	15,000	15,000
Pub, Diskoteka	20,000	20,000
Bar, Restorant, Fast Food, Kafe internet, etj të ngjashme me to	20,000	20,000
Zënie Tregti Peshku	10,000	10,000
Ambulant	5,000	5,000


TARIFA E PASTRIMIT (BIZNESI I VOGËL)

TIPI AKTIVITETIT	ZONA-A	ZONA-B
Hotele, Motele, Komplekse Turistike, Pensione	10,000lekë + 1,000 lekë/dhomë/vit	10,000lekë + 1,000 lekë/dhomë/vit
Shtëpi Pushimi Private	10,000lekë + 1,000 lekë/dhomë/vit	10,000lekë + 1,000 lekë/dhomë/vit
Shtëpi Pushimi Shtetërore	10,000lekë + 500 lekë/dhomë/vit	10,000lekë + 500 lekë/dhomë/vit
Transport Mallrash	10,000	10,000

KAPITULLI 5

5. FOTO NGA DEGJESAT PUBLIKE

NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ DHE ISHËM



NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH DHE KATUND I RI



NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5



NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 4 DHE 6



NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL



NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1, 2 DHE 3

